# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5734
E hënë, 25 mars 2019
çmimi 0.40 €


## Kosova, përjetë mirënjohëse NATO-s

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE" DREJTORI I KLINIKËS SË NEUROKIRURGJISË NË QKUK, PROF. DR. ARSIM MORINA FAQE 4-5



# Të ndalet praktika e të punuarit edhe në QKUK edhe në ordinanca private

Drejtori i Klinikës së Neurokirurgjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), prof. dr. Arsim Morina, ka thënë se duhet të ndërpritet ndarja e buxhetit për shërbime jashtë vendit në mënyrë që ky buxhet të investohet në Kosovë, por përjashtim të kenë vetëm rastet specifike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se ka raste kur pacientët me tumor kanë kërkuar ndihmë mjekësore jashtë vendit, por shpëtimin e kanë gjetur sërish në Kosovë, në Klinikën e Neurokirurgjisë. Ai ka thënë se është kundër praktikës që mjekët të punojnë edhe në sektorin publik, edhe në atë privat. Morina ka thënë se dikujt po i konvenon që të kontrabandojë me pacientët nga sektori publik në atë privat. Në këtë intervistë Morina ka folur edhe për ikjen e kuadrit shëndetësor nga Kosova. Ai ka thënë se Kosovën po e lënë profesionistët, ata që kanë përfunduar fakultetin dhe specializimin me meritë

## EPOPEJA E DUKAGJINIT, KTHESË HISTORIKE PËR LIRI DHE PAVARËSI




Epopeja e UÇK-së në Dukagjin ishte kthesë historike në luftën për liri dhe pavarësi. Kështu është thënë të dielën nga të pranishmit në manifestimin shtetëror kushtuar 21-vjetorit të betejës së Gllogjanit. Me këtë rast, drejtuesit e institucioneve shtetërore, presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj, kanë vlerësuar lart kontributin e ushtarëve të UÇK-së në luftën për liri. Duke vlerësuar rezistencën dhe heroizmin e dëshmorëve të lirisë, presidenti Thaçi i ka dekoruar me urdhrin "Hero i Kosovës" dymbëdhjetë dëshmorët e Gllogjanit me rrethinë FAQE 7

## Kadri Veseli takohet në Shkup me homologun e vet Talat Xhaferin

FAQE 6



## AKTUALE

### IDEJA PËR NDËRHYRJEN E NATO-S NË KOSOVË NË VITIN 1999 NË DRITËN E BURIMEVE ARKIVORE AMERIKANE F. 10

Prof. dr. Ibrahim GASHI



### KOSOVA, SASI TË PAMJAFTUESHME TË UJIT TË PIJSHËM F. 2



## EKONOMI

### QË TË ULET IMPORTI, KËRKOHET MBËSHTETJE E EKSPORTUESVE VENDORË F. 9

### KOSOVA MUND 'TË EKSPORTOJË' TEKNOLOGJI INFORMATIVE PARA RESURSEVE NATYRORE F. 9

## KULTURË

### ISAK SHEMA, FITUES I ORËS SË MADHE LETRARE 'FLAKADANI I KARADAKUT' F. 6

## SPORT

### KOSOVA ME FITORE SYNON T'I NISË KUALIFIKIMET PËR 'EURO 2020' F. 16




RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Fushatë e ashpër në rrjetet sociale e kandidatëve për president të Maqedonisë

Edhe pse fushata parazgjedhore do të nisë më 1 prill, kandidatët për president të ri të Maqedonisë së Veriut fushatën e kanë nisur shumë kohë më parë edhe në rrjetet sociale, duke shkëmbyer akuza dhe pikëpamje të ndryshme lidhur me zhvillimet në vend

Shkup, 24 mars - Në garën për presidentin e ri të Maqedonisë së Veriut do të marrin pjesë tre kandidatë që tashmë janë verifikuar edhe nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Stevo Pendarovski nga partitë në pushtet të udhëhequra nga LSDM-ja, Gordana Siljanovska nga VMRO DPMNE-ja dhe Blerim Reka nga opozita shqiptare. Secili prej tyre pret fitore duke lavdëruar konceptin e tyre si më të mirin të mundshëm. "Pa dyshim se kandidatura e Pendrarovskit është zgjedhje për të gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut, për shtet stabil, të sigurt dhe të përparuar, president i cili do ta çojë vendin drejt NATO-s dhe BE-së", ka deklaruar Aleksandar Kiracovski, drejtues i Shtabit Zgjedhor të Lidhjes Social Demokrate.

Nga opozita maqedonase thonë se kandidatja e tyre është zgjedhja e vetme për qytetarët për t'i demaskuar të gjitha paaftësitë e qeverisjes së tanishme dhe vendimet që ka marrë në dëm të shtetit. "Do të vizitojmë çdo familje që t'i tregojmë të vërtetën, atë që po ndodhë në Maqedoni, por edhe do t'i flasim edhe për periudhën kur ne ishim në pushtet. Nga kjo qeveri e korruptuar dhe e paaftë po përballemi me gjendje të rëndë në vend. Për shkak të kësaj dhe vendimeve të dëmshme për vendin dhe qytetarët, ajo duhet sa më parë të largohet nga pushteti", ka deklaruar Vllado Misajllovski, nënkryetar i VMRO DPMNE-së.

Nga shtabi zgjedhor i kandidatit për president të opozitës shqiptare thonë se "koncepti i profesorit Blerim Reka, e bën atë të veçantë nga kandidatët e tjerë. Ne preferojmë që ai vetë ta prezantojë programin e tij. Do të kemi një fushatë pak më ndryshe, do të kemi një koncept të ri".

Fushata parazgjedhore do të nisë më 1 prill, por kandidatët e partive, në veçanti Stevo Pendarovski dhe Gordana Siljanovski fushatën e kanë nisur shumë kohë më parë edhe atë në rrjetet sociale duke shkëmbyer akuza e pikëpamje të ndryshme lidhur me zhvillimet në vend.

Ekspertët thonë se shfrytëzimi i rrjeteve sociale është pozitiv, por këtë rast sipas Bojar Koradlov, specialist për marrëdhënie me publikun, komunikimi është i njëanshëm. "Një nga gabimet me këtë lloj të fushatës është se ata vetëm se prezantojnë qëndrimet e tyre dhe nuk komunikojnë me elektoratin. Çështja e dytë është se nuk kanë qasje profesionale pasi shpesh dinë të favorizojnë një media, apo të mbyllen në rrethin e vetëm një rrjeti social dhe fare të mos komunikojnë me mediet e tjera apo ato tradicionale. Ata konsiderojnë se duhet të jenë gjithkund aktivë nëse duan të tërheqin sa më shumë votues", thotë Bojan Koradlov, ka njoftuar rfe.

Por, duke parë devijimin e fushatës në çështje që nuk janë në kompetencë të presidentit, tensionet në opinion, shpenzimet e shumë parave për fushata zgjedhore, disa nga ekspertët thonë se më mirë do të ishte sikur zgjedhja e presidentit të bëhet në Kuvend dhe jo në zgjedhje të drejtpërdrejta. "Nuk mundet që tërë fushatën ta mbani vetëm se në sferën e p olitikës jashtme apo në reformat që kanë të bëjnë me inteligjencien dhe politikat e armatës. Këto janë sfera ku presidenti ka kompetenca dhe kur mundësitë janë të kufizuar normalisht se kandidatët dalin edhe jashtë sferave të tyre të ndikimit duke bërë edhe premtime të tjera. Konsideroj se duhet të ndryshojë mënyra e zgjedhjes së presidentit. Për t'iu ikur harxhimeve, fushatave elektorale e procedurave të tjera do të ishte mirë që presidenti përfundimisht të zgjidhet në Kuvend", thotë Marko Trashanovski nga Instituti për Demokraci.

Zgjedhjet mbahen në dy raunde zgjedhore më 21 prill dhe 5 maj. Dy kandidatët me më shumë vota kalojnë në rrethin e dytë zgjedhor dhe kandidati që do të marrë më shumë vota nga dalja e qytetarëve në votime, që duhet të jetë mbi 40 për qind e trupit të përgjithshëm votues, do të jetë pasardhës i Gjorge Ivanovit në postin e presidentit të ri të Maqedonisë së Veriut. (REL)





MIA

## Rama: Shkojmë në zgjedhje, nëse më 30 qershor opozita fiton një bashki më shumë se ne



Tiranë, 24 mars - Opozita proteston prej më tepër se një muaji, madje ka "djegur" mandatet e deputetëve, pasi kërkon zgjedhje të parakohshme me qeveri transitore, pa Ramën si kryeministër. Në fjalën e tij, ku prezantoi Veliajn si kandidat për një tjetër mandat në bashkinë e Tiranës, kryeministri Edi Rama pati edhe një sfidë për opozitën. Ai ka deklaruar se zgjedhjet e qershorit do të zhvillohen edhe pa ata, ndërsa u zotua se do ta çojë vendin në zgjedhje të parakohshme, nëse opozita do të marrë qoftë edhe një bashki më shumë sesa ata më 30 qershor. "Nëse ju në zgjedhjet e 30 qershorit, do të fitoni një bashki më shumë se ne, jemi të gatshëm të shkojmë në zgjedhje të parakohshme. E di që ju s'do ta pranoni këtë sfidë. Ju se mundni dot PS-në as në Kukës dhe as në Skrapar, dhe lërë më pastaj në të gjithë Shqipërinë", ka thënë Rama. Kryeministri më pas i bëri thirrje edhe një herë bllokut opozitar që të rikthehet në tryezë për të punuar për reformën në drejtësi. "Unë e kam një ftesë për ju, jeni ju që ua keni rrokanisur kokën ndërkombëtarëve për reformën zgjedhore. Hajdeni ulemi ta miratojmë së bashku atë reformë, të biem dakord t'i eksperimentojmë në disa zona edhe votimin, edhe numërimin elektronik. Meqë keni shumë qejf shitblerjen e votës, do ta miratojmë çdo masë që do të propozojë në Parlament doktoresha e shitblerjes së votës. Ne i votojmë vetë në Parlament me deputetë e rinj që ju i keni zgjedhur", ka thënë Rama.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Njëzetë vjet nga fillimi i bombardimeve të NATO-s

# Kosova, përjetë mirënjohëse NATO-s

Liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës kanë shprehur mirënjohjen e tyre për intervenimin e NATO-s mbi caqet e ish-Jugosllavisë. Në 20-vjetorin e fillimit të fushatës 78 ditore, e cila çoi në përfundimin e luftës në Kosovë, ata kanë thënë se ndërhyrja e kësaj aleance nga ajri i hapi rrugë çlirimit të Kosovës dhe i dha fund gjenocidit serb mbi qytetarët e Kosovës



EPOKA E RE Muhamet KOCI

**Prishtinë, 24 mars** - Në 20-vjetorin e fillimit të bombardimeve të NATO-s mbi caqet e ish-Jugosllavisë, liderët politikë të Kosovës kanë shprehur mirënjohje për NATO-n dhe ShBA-në. Duke e vlerësuar lart kontributin e bashkësisë ndërkombëtare, ata kanë deklaruar se 24 marsi i vitit 1999 ishte pikënisje e ndalimit të gjenocidit dhe rikthim i shpresës për liri të popullit të Kosovës.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se pas dështimit të përpjekjeve diplomatike për ta detyruar Serbinë që t'i ndërpriste ofensivat brutale dhe masakrat mbi popullsinë civile në Kosovë, ish-sekretari i NATO-s, Javier Solana, më 23 mars 1999 kishte urdhëruar fillimin e sulmeve të NATO-s kundër forcave serbe. "Edhe sot kur i kujtojmë këto ditë, dy dekada pas, e kemi të freskët gëzimin e madh që përjetuam në ato çaste tejet të vështira për popullin tonë. Kjo ishte pikënisje e ndalimit të gjenocidit dhe rikthim i shpresës sonë për liri dhe pavarësi. UÇK-ja në tokë dhe NATO-ja në ajër, në luftën e përbashkët për paqe, e detyruan kapitullimin e regjimit të Millosheviqit", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook", duke shtuar se Republika e Kosovës do të mbetet atdhe i të gjithë qytetarëve të saj.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se Kosova do të jetë përjetësisht mirënjohëse ndaj udhëheqësve të botës demokratike në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "20 vjet më parë NATO filloi sulmet mbi Serbinë, për t'i dhënë fund terrorit të saj gjenocidal në Kosovë. Populli i Kosovës do të jetë përjetësisht mirënjohës ndaj udhëheqësve të botës demokratike në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ata ishin me ne, në orën më të ligë të historisë sonë. Ne jemi krenarë që aleancën me NATO-n, të filluar nga UÇK-ja, sot po e vazhdon Ushtria e Kosovës. Gjithmonë në shërbim të lirisë dhe paqes", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Në shenjë mirënjohjeje për kontributin, ndihmën dhe sakrificën sublime të grave dhe burrave të kombeve të lira, kryeministri Ramush Haradinaj, së bashku me kabinetin qeveritar, ka bërë nderim te pllaka përkujtimore për ushtarët e KFOR-it në Sheshin "Nëna Terezë", si dhe te pllaka përkujtimore e ushtarëve britanikë në Sheshin "Edith Durham". "Dy dekada më parë filloi historia e re e Kosovës, kur bota e lirë, përmes fushatës ajrore të NATO-s, ndërpreu tragjedinë e popullit tonë, shpëtoi shumë jetë dhe mundësoi rikthimin për jetë në liri të popullit të Kosovës", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurse zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se më 24 mars të vitit 1999 forcat e NATO-s nisën fushatën e bombardimeve mbi caqet serbe për t'i dhënë fund dhunës, masakrave dhe spastrimit etnik që po bëheshin mbi qytetarët e Kosovës nga forcat serbe. "Ndërhyrja e NATO-s nga ajri i hapi rrugë çlirimit të vendit dhe i dha fund gjenocidit serb mbi qytetarët e Kosovës. Në prag të 20-vjetorit të ndërhyrjes së NATO-s kujtojmë dhe nderojmë të gjithë ata ushtarë që kanë humbur jetën gjatë shërbimit në Kosovë", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe liderët e opozitës kanë shprehur mirënjohjen e tyre për ndërhyrjen e NATO-s.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, në profilin e vet në "Facebook" ka shkruar se intervenimi i Aleancës Veriatlantike ndaj caqeve ushtarake serbe para 20 vjetëve ishte dita e përcaktimit të fatit për qytetarët e Kosovës. "Ndërhyrja e NATO-s, krahas rezistencës paqësore të ideuar dhe të drejtuar nga presidenti historik, Ibrahim Rugova dhe luftës heroike të UÇK-së, hapi horizontin e lirisë në Kosovë. Në vatrat e tyre të djegura e të shkatërruara u kthyen mbi një milion njerëz që ishin deportuar nga ushtria dhe forcat paramilitare serbe. NATO-ja dhe vlerat perëndimore janë dhe mbeten besimi dhe synimi ynë i palëkundur. Gjithherë do t'u jemi mirënjohës", ka shkruar Mustafa.

Ndërsa kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se kanë qenë tri arsye kryesore pse NATO-ja ka hyrë në luftë para dy dekadash. Sipas tij, kjo ka ndodhur sepse ish-presidenti i Jugosllavisë, Slobodan Millosheviq, nuk pranoi ta nënshkruante dokumentin e Rambujesë, që Kosova të mos bëhej Bosnje dhe që Maqedonia të mos bëhej Kosovë. "Dita e parë dhe e fundit e këtij intervenimi 78 ditor ishin më të mirat. Sepse u godit Serbia dhe sepse u dorëzua ajo. Midis këtyre dy çasteve kemi mesatarisht nga 5 masakra në ditë kundër shqiptarëve anembanë Kosovës. Në këtë pranverë populli i Kosovës do të përkujtojë mijëra 20 vjetorë, të dhembjes e pikëllimit për humbjet e vuajtjet, të krenarisë e shpresës për vendosmërinë dhe ardhmërinë", ka shkruar Kurti.

Pas 78 ditë bombardimesh të NATO-s, Sllobodan Milloshevqi, në atë kohë president i Serbisë, u dorëzua në qershorin e vitit 1999 dhe pranoi marrëveshjen e Kumanovës. Më 10 qershor Këshilli i Sigurimit ka miratuar Rezolutën 1244, me të cilën vendosi administratën e përkohshme të OKB-së në Kosovë dhe fuqizoi praninë ushtarake të KFOR-it. Më pas, Kosova, në partneritet me bashkësinë ndërkombëtare, ka themeluar institucionet e saj, të cilat më 17 shkurt të vitit 2008 shpallën pavarësinë e Kosovës.

## Kosnetti: ShBA-ja mbështeti NATO-n për t'i dhënë fund spastrimit etnik në Kosovë nga regjimi i Milloshevqit

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë se 20 vjet më parë ShBA-ja ka mbështetur intervenimin e NATO-s për t'i dhënë fund regjimit të spastrimit etnik të Milloshevqit pas dështimit të përpjekjeve diplomatike për të arritur një zgjidhje paqësore. Në një adresim në 20-vjetorin e bombardimeve të NATO-s, ambasadori Kosnett ka pohuar se tani është koha që Kosova dhe Serbia të ndërtojnë shoqëri ku të gjitha komunitetet jetojnë bashkë në paqe dhe me dinjitet. Ai ka bërë thirrje që të shtohen përpjekjet për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur në Kosovë. "Pra, sot, si reflektim, unë bëj thirrje për veprim. Inkurajoj Qeverinë e Kosovës dhe të Serbisë të garantojnë se viktimat dhe familjet e tyre të të gjitha kombësive dhe komuniteteve kanë qasje të plotë në informata për fatin e të zhdukurve. Si dhe bëj thirrje te të dyja qeveritë t'i rrisin përpjekjet për të vendosur drejtësi për viktimat e krimeve të luftës", është shprehur Kosnett.



Flet për "Epokën e re" drejtori i Klinikës së Neurokirurgjisë në QKUK, prof. dr. Arsim Morina

# Të ndalet praktika e të punuarit edhe

## - Klinika e Neurokirurgjisë ka nevojë për pesë specializantë



**Drejtori i Klinikës së Neurokirurgjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), prof. dr. Arsim Morina, ka thënë se duhet të ndërpritet ndarja e buxhetit për shërbime jashtë vendit në mënyrë që ky buxhet të investohet në Kosovë, por përjashtim të kenë vetëm rastet specifike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se ka raste kur pacientët me tumor kanë kërkuar ndihmë mjekësore jashtë vendit, por shpëtimin e kanë gjetur sërish në Kosovë, në Klinikën e Neurokirurgjisë. Ai ka thënë se është kundër praktikës që mjekët të punojnë edhe në sektorin publik, edhe në atë privat. Morina ka thënë se dikujt po i konvenon që të kontrabandojë me pacientët nga sektori publik në atë privat. Në këtë intervistë, Morina ka folur edhe për ikjen e kuadrit shëndetësor nga Kosova. Ai ka thënë se Kosovën po e lënë profesionistët, ata që kanë përfunduar fakultetin dhe specializimin me meritë**

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 MARS -

**"Epoka e re":** *Z. Morina, në çfarë kushtesh po punohet në QKUK, konkretisht në Klinikën e Neurokirurgjisë?*

**Morina:** Qendra jonë është e vetmja në Kosovë që kemi edhe pacientë të cilët gravitojnë nga Kosova Lindore dhe Mali i Zi por, fatkeqësisht, jemi të limituar sa i përket hapësirës dhe aktualisht punojmë vetëm me një sallë operative. Për disa sëmundje jemi të detyruar të bëjmë listë të pritjes, pasi gjatë një dite në të shumtën e rasteve mund të operohet vetëm një person. Ta kishim edhe sallën tjetër të cilën na shfrytëzon kirurgjia plastike nuk do të kishte listë të gjatë të pritjes së pacientëve për operim. Ajo sallë është në plan të lirohet. Pra, ta kishim në shfrytëzim do të mund t'i kryenim dhe tri operime të tjera në sallën tjetër operative, njëkohësisht ditët e qëndrimit në spital do të ishin shumë më të vogla. Derisa unë do ta kryeja një operim të rëndë të tumorit, kolegët në sallën tjetër do të mund t'i kryenin operimet e tjera më të lehta dhe nuk do të kishim listë të pritjes aq gjatë. Shëndetësia në Kosovë ka disa shtylla që duhet të ketë progres, në ndarje mes sektorit publik dhe ordinancave private. Pastaj duhet të ndërpritet ndarja e buxhetit për shërbime jashtë vendit, në mënyrë që ky buxhet të investohet në Kosovë. Pra, aty ku nuk ka pajisje të blihen e aty ku nuk dihet të punohet, të mësohemi të punojmë. Të gjitha rastet duhet të trajtohen në Kosovë nëse jemi shtet i pavarur. Në këtë mënyrë do ta eliminojmë listën e pritjes e cila po i konvenon dikujt që të kontrabandojë me pacientët nga sektori publik në atë privat.

**"Epoka e re":** *A ka kuadro të mjaftueshëm në Klinikën e Neurokirurgjisë?*

**Morina:** Në vazhdimësi ka nevojë për kuadër profesional dhe për pajisje profesionale. Keni parasysh se për lëmin tonë nevojiten gjashtë vjet specializim, për faktin se është lëmë i rëndë dhe për atë dhe llogaritet 'mbretëresha e kirurgjisë'. Në lëmenjtë e tjerë mund të ketë riprovim nëse ka dëmtim të një zorre dhe pas një kohe shfaqet nevoja për të intervenuar, pastaj sërish mund të pritet, aq sa është e nevojshme. Kurse te lëmi ynë, nëse e bëjmë një gabim, nuk ka kthim pas, do të thotë nuk ka riprovim. Prandaj gjithë kohën punohet kur ka gjak. Nuk mund të ndalet qarkullimi i gjakut në tru dhe të punojmë lirshëm siç është në lëmenjtë e tjerë. Edhe në Kardiokirurgji ndalet zemra, operohet dhe s'ka gjakderdhje, pasi punon aparatura, kurse ne nuk mund ta ndalim qarkullimin e gjakut.

**"Epoka e re":** *Kemi një trend të ikjes së mjekëve dhe infermierëve nga Kosova. A po rrezikohemi për deficit të kudrave të mjekësisë?*

**Morina:** Fatkeqësisht, për të dalë jashtë vendit ka tendencë të profesionistëve dhe atyre që e kanë përfunduar fakultetin dhe specializimin me meritë. Pra, nuk dalin kuadrot që janë më pak të përgatitura, pasi ata shfrytëzojnë lidhje të ndryshme dhe stabilizohen. Numerikisht nuk është numër i lartë, por kualitativisht po. Studentët më të mirë nuk gjejnë vend të punës dhe nuk u jepet e drejta për specializim, pastaj janë të detyruar ta marrin rrugën e kurbetit. Kjo është brengë. Edhe unë djalin tim e kam jashtë shtetit, në Gjermani. Me profesion është neokirurg. Ka studiuar në Gjermani dhe ka mbetur atje, si shumë të tjerë.

**"Epoka e re":** *A do të ketë konkurs për specializim, edhe pse kjo varet nga Ministria e Shëndetësisë.*

**Morina:** Fatkeqësisht, çështja e specializimit është e centralizuar dhe kjo varet nga Ministria e Shëndetësisë. Ka vite që bëj kërkesa për pranim të specializimit, por kandidatët përzgjidhen nga Ministria e Shëndetësisë. Në vendet perëndimore ai që plotëson kriteret pranohet, kurse te ne ndodh që të pranohet lista që e sjell Ministria e Shëndetësisë. Një gjë e tillë duhet të ndryshohet, në mënyrë që

### Porosia e Morinës për studentët e mjekësisë: Profesionin e mjekut ta bëjnë me shumë vullnet

**"Epoka e re":** *Z. Morina, cili është mesazhi juaj për studentët që studiojnë mjekësinë?*

**Morina:** Të punojnë sa më shumë dhe me shumë vullnet, pra jo me zor. Studentët jo që duhet ta kryejnë mjekësinë dhe punën e mjekut, por duhet të ndiejnë kënaqësi për punën që bëjnë. Të jenë të mirësjellshëm me pacientët pasi cilado patologji apo sëmundje është armik i përbashkët, edhe i pacientit, por edhe i mjekut. Këtë armik as pacienti nuk mund ta luftojë vetë, por as mjeku nuk mund ta luftojë pa pacientin. Prandaj ata duhet të jenë së bashku kundër armikut të përbashkët dhe punën duhet ta kryejnë me seriozitet dhe përkushtim.

# e në QKUK edhe në ordinanca private



përzgjedhja të bëhet nga ana jonë.

**"Epoka e re":** *Për cilët lëmë ka më së shumti nevojë për specializim?*
Morina: Secili drejtor i klinikës në QKUK i bënë kërkesat aq sa ka nevojë. Mund të them se ne tani kemi nevojë për pesë specializantë, por kjo varet nga Ministria e Shëndetësisë kur shpallet konkursi. Megjithatë, prapëseprapë jemi të pafuqishëm në këtë drejtim, pasi përzgjedhja bëhet nga ministria.

**"Epoka e re":** *Rrija e pagave, a është stimuluese për mjekët ashtu siç është paraparë në Ligjin për nivelizim pagash?*
**Morina:** Ende nuk i kanë marrë pagat me rritje derisa Ligji të hyjë në fuqi. Unë nuk jam ithtar që rritja të bëhet ashtu gjenerale në mënyrë uniforme. Duhet të ndërrohet kjo praktikë. Të shikohet ashtu siç e kanë bërë shumë vende evropiane, tash së fundi edhe Kroacia. Gjithashtu, duhet ta ndalim praktikën e të punuarit edhe në QKUK edhe në ordinanca private. Kush dëshiron të punojë në ordinancë private le të urdhërojë dhe paga më pas t'u rritet atyre që vendosin t'i rrinë besnik sektorit shtetëror. E përsëris, nuk mendoj se rritja e pagave do të duhej të bëhej në mënyrë uniforme.

**"Epoka e re":** *Paraprakisht më thatë se ju nuk punoni në ordinanca private. Rast i rrallë të dëgjohet në Kosovë.*
Morina: Është konflikt interesi të punohet edhe në sektor publik, edhe në atë privat, pasi kjo shërben si trampolinë e kontrabandimit të pacientëve. E shihni si kanë mbirë ordinancat private si kërpudhat, madje edhe në oborrin e spitalit është një e ashtuquajtur 'Klinikë Amerikane', e mos të flasim për kilometra më larg ku janë qindra ordinanca private. Nga aeroplani shihet se është konflikt interesi. Nëse dikujt i duken pagat e vogla në spital, le të urdhërojë të punojë në ordinancë private dhe vetëm atyre që mbesin të përkushtuar në spitale shtetërore t'u rriten pagat.

**"Epoka e re":** *Cila është zgjidhja që duhet të bëhet në këtë rast sa iu përket ordinancave private, në mënyrë që t'i shmanget konfliktit të interesit?*
**Morina:** Së pari duhet të verifikohen kredencialet. Ju e dini pas luftës disa individë se si kanë dalë të specializuar, duke sjell diploma nga kahmos. Pra, duhet të vërtetohet validiteti i diplomave, pastaj ka shumë dyshime se si i kanë marrë licencat e punës për të gjitha lëmenjtë. Mos të harrojmë se kemi mori specializantësh që po kërkojnë punë. Prapë dua të ndërlidhem tek ordinancat private të cilat po bëjnë konkurrencë jolojale në këtë drejtim, duke bërë që shumë mjekë t'i zënë dy vende të punës. Me ndarjen e publikes nga privatja do të krijoheshin shumë vende për mjekët e rinj, prandaj s'ka kurrfarë logjike që të punohet në të dy sektorët. Derisa të vazhdojë kjo punë kështu, atëherë kjo shkon në interes për trafikim të pacientëve dhe ordinancat private do të shërbejnë si trampolinë. Sektorin shtetëror nuk duhet ta dëmtojë asgjë. Atij që i konvenon për të punuar në QKUK le të punojë, nëse jo, le ta vazhdojë punën në ordinanca private dhe kështu lirohet rruga për mjekët e rinj. Për këtë kompetencë është Ministria e Shëndetësisë dhe deputetët e zgjedhur nga populli, të cilët duhet t'i japin zgjidhje këtij problemi.
Gjithkund në botë gravitojnë nga spitalet e vogla në të shtetit, e jo të dërgohen pacientët nga QKUK-ja në ordinanca private. Kur pacientët po kanë implikime, na i sjellin në QKUK. Kjo më të vërtetë është dukuri shqetësuese. Unë për vete loboj që të ndalet kjo dukuri, pasi QKUK-së askush nuk mund t'i bëjë konkurrencë.

**"Epoka e re":** *Z. Morina, cilat janë rastet më të komplikuara në të cilat intervenoni në QKUK?*
**Morina:** Rastet që janë më sfiduese kanë të bëjnë me kirurgjinë e enëve të gjakut të trurit. Këto raste janë mjaft interesante dhe sfiduese, por edhe të rënda. Pastaj janë tumoret e bazës së trurit që zgjasin me orë të tëra, deri në 12 orë mund zgjasë një operacion. Kjo është edhe sfidë, por në anën tjetër edhe kënaqësi, kur pas operimit pacienti është mirë. Këto ditë ne kishim një pacient, me mbiemrin Maloku, operacioni i të cilit zgjati gjashtë orë. Ne në Neurokirurgji intervenuam në një rast, ku pacienti më parë kishte qenë në Beograd për operim dhe ne përmirësuam gabimet e tyre.

**"Epoka e re":** *Është sfiduese të qëndrosh 12 orë në sallë operacioni?*
Morina: Koha në sallën e operacionit kalon shumë shpejt pasi je i koncentruar në punën që bën dhe fare nuk je i koncentruar se sa orë mund të zgjasë. Nuk ndien as etje, as lodhje dhe as uri. Vetëm në fund sheh sa ka shkuar ora.

**"Epoka e re":** *Kemi një numër të madh të pacientëve të cilët po kërkojnë shërim jashtë vendit, në Beograd, Shkup dhe Tiranë, në saje të pritjeve të gjata në QKUK?*
**Morina:** Nuk dua të ndalem as te Beogradi, Shkupi apo Tirana. Pacientët tanë duhet të shërohen në Kosovë pasi tanimë jemi shtet. Duhet ta heqim listën e pritjeve dhe të na lirohet salla në Neurokirurgji. Në gjithë këtë drejtim vetëm nevojitet vullnet dhe automatikisht hiqet lista e pritjes. Pacientët duhet të dalin jashtë vendit vetëm në raste shumë specifike, shembull nëse kanë nevojë për metoda të kirurgjisë me atë të 'gama rrezeve', pasi aparaturat janë të shtrenjta dhe për një shtet prej dy milionë banorësh nuk ia vlen të blihen pajisje milionëshe, atëherë rastet e tilla logjikisht mund të kërkonin ndihmë jashtë vendit, por jo edhe për sëmundjet e tjera. Prandaj duhet të bëhet një plan i mirëfilltë, afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

# Kadri Veseli takohet në Shkup me homologun e vet Talat Xhaferin

SHKUP, 24 MARS (ER) - Në 20-vjetorin e fillimit të sulmeve ushtarake të NATO-s ndaj forcave ushtarake të Serbisë, të dielën kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka qëndruar në Maqedoninë e Veriut, ku është takuar me homologun e vet Talat Xhaferi. Veseli ka thënë se Maqedonia e Veriut ka dhënë kontribut të çmuar duke hapur rrugët e bashkëpunimit për forcat e NATO-s të cilat nga aty janë futur në Kosovë për t'u dalë në ndihmë qytetarëve tanë. "Po ashtu, mirënjohje për bashkëkombësit tanë në Maqedoninë e Veriut për strehimin dhe ndihmat që kanë dhënë për qytetarët e Kosovës të dëbuar dhunshëm nga forcat serbe. Ne nuk do ta harrojmë asnjëherë ndihmën e miqve tanë anembanë botës në kohën e luftës. Ju jemi mirënjohës përjetë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".



# Kuvendi i Komunës së Mitrovicës nderoi Latif Berishën dhe Agim Hajrizin

MITROVICË, 24 MARS (ER) - Me një mbledhje solemne, të thirrur nga kryesuesi Safet Kamberi, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës ka nderuar dhe përkujtuar dy nga personalitetet më emblematike të qytetit të Mitrovicës, Latif Berishën dhe Agim Hajrizin, të cilët ishin shpirti i lëvizjes për liri dhe demokraci jo vetëm në Mitrovicë, por edhe më gjerë, që mizorisht u ekzekutuan në natën e 24 marsit të vitit 1999 nga policia fashiste serbe.

Në këtë mbledhje kanë marrë pjesë edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës, Ismet Beqiri, Anton Çuni, zëvendësministrat Gjergj Beka e Sami Zeka, përfaqësues të institucioneve të tjera qendrore dhe lokale, veprimtarë të çështjes kombëtare, personalitete të jetës politike, kulturore etj.

Në adresimin para të pranishmëve, kryesuesi i Kuvendit të Komunës, njëherësh edhe kryetar i Degës së LDK-së në Mitrovicë, Safet Kamberi, ka thënë se Latif Berisha dhe Agim Hajrizi ishin atdhetarë të devotshëm, intelektualë të shquar, veprimtarë të palodhur e të paharruar, familjarë shumë të dashur, bashkëpunëtorë të ngushtë dhe besnikë. "Njëzet vjet më parë Kosova dhe populli i saj po përjetonin gjenocid të paparë shtetëror serb. Bota progresive ndërkombëtare, NATO, u angazhuan dhe nuk lejoi që të thellohet edhe më tej kjo tragjedi, prandaj vendosën ta ndëshkonin Serbinë, duke i bombarduar caqet ushtarake dhe policore të saj. Natën e 24 marsit, kur filluan bombardimet, kriminelët serbë ekzekutuan në mënyrën më mizore në shtëpitë e tyre dy nga personalitetet më emblematike të qytetit të Mitrovicës, Latif Berishën dhe Agim Hajrizin, që deri në ato çaste ishin shpirti lëvizjes për liri dhe demokraci jo vetëm në Mitrovicë, por edhe më gjerë. Kështu, këta intelektualë dhe veprimtarë të devotshëm të qytetit tonë dhe të mbarë shqiptarisë shkuan nga kjo botë pa e pritur agimin e lirisë", ka theksuar Kamberi.



Nënkryetari i Mitrovicës, Faruk Mujka, duke folur për atdhetarët Berisha dhe Hajrizi, ka thënë se puna e tyre me përkushtim, ideali i lartë patriotik dhe kombëtar, mbeten gjithmonë në zemrat e popullit tonë dhe se ata në këtë fushë dhe shumë të tjera ishin fanar i ndriçimit atdhetar, në të gjitha hapësirat.

Ndërkaq sekretari i LDK-së, Ismet Beqiri, ka thënë se ndihet i privilegjuar që kishte pasur rastin t'i njoh nga afër shumë mirë të dy këta patriotë. Ai ka thënë se Latif Berisha dhe Agim Hajrizi ishin figura shumë të çmuara dhe kontributdhënëse për lirinë të cilën populli i Kosovës e gëzon sot. Në emër të familjarëve të pranishmit i ka falënderuar e bija e profesor Berishës, Fatmirja dhe motra e Agim Hajrizit.

# Kosova, sasi të pamjaftueshme të ujit të pijshëm

PRISHTINË, 24 MARS - Rreth 92 për qind e popullatës së Kosovës llogaritet se ka qasje në furnizim me ujë të pijshëm prej sistemeve qendrore që furnizohen nga shtatë kompani. Uji i pijshëm është sipas standardeve të Bashkimit Evropian, thonë zyrtarët e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik. Megjithatë, pjesa tjetër e popullatës furnizohet me ujë alternativ qoftë prej puseve apo burimeve të ngjashme. Ky ujë vlerësohet se nuk i përmbush standardet e parapara për pije. Si rrjedhojë, banorët që e përdorin këtë ujë janë të rrezikuar më shumë nga infeksionet, bakteret, diarreja e të tjera.

Burbuqe Nushi, koordinatore në Qendrën e Monitorimit të Ujit në Institutin Kombëtar, thotë se duhet të arrihet synimi që 99 për qind e popullatës të kenë qasje në ujë të pijshëm, në mënyrë që institucionet e Kosovës ta shohin si rezultat çështjen e ujit të pijes. "Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik është trup monitorues për ujin e pijshëm në Kosovë. Në bazë të të dhënave të autoritetit rregullator, 92 për qind e popullatës ka qasje në furnizim me ujë prej sistemeve qendrore që realizohet përmes shtatë kompanive. Nëse u referohemi rezultateve të monitorimit, më shumë se 99 për qind është në përputhje në aspektin mikrobiologjik, 98 për qind është me aspektin kimik dhe në përgjithësi uji i pijshëm është 98.85 për qind, që do të thotë se qëndrojmë mirë si vend në raport me ujin. Instituti punon me direktiva të Bashkimit Evropian. Uji me të cilin furnizohemi është brenda standardeve të parapara evropiane, megjithatë duhet të arrihet 99 për qind në të tri nivelet", ka thënë ajo, raporton "Rel".



Sa i përket furnizimit me ujë, Ilir Abdullahu, kryeshef i Ujësjellësit Rajonal "Prishtina", ka thënë se uji duhet të përdoret në mënyrë shumë racionale dhe të mos keqpërdoret, sepse liqenet artificiale, ai i Batllavës dhe i Badovcit, janë katër metra nën nivelin e duhur. Megjithatë, ai shpreson se muajt e ardhshëm do të ketë reshje atmosferike, ashtu siç ndodh çdo vit, në mënyrë që këto liqene të akumulojnë ujë, i cili më pas shndërrohet në ujë të pijes. "Vendi ynë, por edhe ne si kompani, jemi duke ndërmarrë masa që resurset ujore të menaxhohen dhe të ruhen që të mos vijmë në një situatë siç ka ndodhur më herët që kemi pasur thatësi të madhe dhe si rrjedhojë mungesë uji. Në këtë ditë ne bëjmë apel që uji i pijes të ruhet dhe të mos keqpërdoret, në mënyrë që rezervat të mos shkojnë drejt rënies", ka thënë Abdullahu.

Të dielën është shënuar 21-vjetori i Epopesë së UÇK-së në Dukagjin

# Epopeja e Dukagjinit, kthesë historike për liri dhe pavarësi

Epopeja e UÇK-së në Dukagjin ishte kthesë historike në luftën për liri dhe pavarësi. Kështu është thënë të dielën nga të pranishmit në manifestimin shtetëror kushtuar 21-vjetorit të betejës së Gllogjanit. Me këtë rast, drejtuesit e institucioneve shtetërore, presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj, kanë vlerësuar lart kontributin e ushtarëve të UÇK-së në luftën për liri. Duke vlerësuar rezistencën dhe heroizmin e dëshmorëve të lirisë, presidenti Thaçi i ka dekoruar me urdhrin "Hero i Kosovës" dymbëdhjetë dëshmorët e Gllogjanit me rrethinë








EPOKA E RE Shqipe HETEMI

**Prishtinë, 24 mars** - Nën përkujdesjen e Qeverisë së Republikës që Kosovës të dielën është mbajtur manifestimi shtetëror kushtuar 21-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Dukagjin. Në përvjetorin e betejës së Gllogjanit kanë marrë pjesë kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, presidenti Hashim Thaçi, Rifat Jashari, vëllai i komandantit legjendar Adem Jashari, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, përfaqësues nga trevat shqiptare, luftëtarë të UÇK-së si dhe qindra qytetarë. Me këtë rast, kryeministri Ramush Haradinaj i ka falënderuar të pranishmit që kanë ardhur për ta nderuar Epopenë e Dukagjinit dhe betejën e Gllogjanit. Ai ka falënderuar presidentin Thaçi për dekorimin e luftëtarëve të Gllogjanit, duke vlerësuar se ishte nder për Gllogjanin që luftëtarët e kësaj treve po nderohen nga shteti i vet. Kryeministri Haradinaj ka thënë se shqiptarët asnjëherë nuk u ndalën së luftuari për të drejtën e vet, por e vetmja herë që u bashkuan ashtu siç i bashkoi Leka qindra vjet përpara ishte bashkimi në UÇK. Haradinaj ka vlerësuar se më 24 mars të vitit 1998 në Gllogjan u vazhdua pushka, nami dhe e drejta e komandantit legjendar Adem Jashari. "Historia e Dukagjinit është jashtëzakonisht e vlefshme dhe e pasur. Dukagjini ka lënë nam në luftëra para pushtuesve në të gjitha kohët e veta, para dhe pas Lekë Dukagjinit. Në UÇK u bashkuam të gjithë, ngado që vinim, kushdo që ishim, u bëmë bashkë, u bëmë një në luftën tonë për liri. U bashkuam në mes vete dhe qëndruam bashkë, në rrethim të hekurt, qëndruam në përballje të vështira, qëndruam në dhimbje të mëdha dhe i përballuam ato dhimbje, ditë me ditë, nga '98 deri më '99, kur ndodhi ajo që të gjithë jemi krenarë, pra NATO-ja, e prirë nga Amerika, që i dha hakun armikut tonë, pra filloi sulmet ajrore mbi caqet e ushtrisë dhe të policisë serbe", ka deklaruar Haradinaj.

Duke kujtuar thënien e Vaso Pashës "nëpër luftëra të rrepta gjithmonë kemi ra, por me faqe të bardhë gjithmonë jemi nda", kryeministri Haradinaj ka thënë se 24 marsi i viti 1998 i përshtatet kësaj thënie. "Luftëtari shqiptar i të gjitha kohëve asnjëherë nuk është ndalur dhe ka luftuar me kode të nderit dhe asnjëherë nuk e ka shkelur këtë kod, duke i ruajtur me mijëra vjet dhe nuk ka gjykatë që i gjen gabim kodet e shqiptarit, të cilat janë kode të nderit e të respektit. Janë kode të atij që di ta ruajë tjetrin dhe ne në Kosovë kemi ditur dhe do të dimë t'i ruajmë të gjitha etnitë që jetojnë me ne dhe për t'i respektuar vlerat e tyre", ka theksuar ai.

Kryeministri ka kujtuar tre luftëtarët e rënë për liri më 24 mars të '98-s, Gazmend Mehmetaj, Himë Haradinaj dhe Agron Mehmetaj. Haradinaj ka nderuar me mirënjohjen "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" tri shoqatat e dala nga OVL e UÇK-së dhe brigadat e Zonës së Dukagjinit.

Ndërsa Rifat Jashari, vëllai i komandantit legjendar, Adem Jashari, ka bërë thirrje për bashkim. Ai ka thënë se jo vetëm në përvjetor, por gjithnjë duhet të jemi të bashkuar si sot në Gllogjan. "Falë gjakut të dëshmorëve e gëzojmë lirinë. Duhet të jemi të bashkuar kështu si sot në Gllogjan", ka deklaruar Jashari.

Ndërkohë presidenti Hashim Thaçi ka thënë se Epopeja e Dukagjinit ka shënuar një kthesë historike në luftën për liri, çlirim dhe pavarësi. "Sot kujtojmë me pietet dhe respekt Epopenë e Dukagjinit, kujtojmë dhe vlerësojmë lart mbështetjen ndërkombëtare të cilën duhet ta ruajmë si sytë e ballit në rrugëtimin tonë për anëtarësim në NATO, Bashkim Evropian dhe raporte speciale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Madhështia dhe vlera më e madhe e kësaj date i shtohet kur kemi parasysh se më 24 mars 1999, 20 vjet më parë, filluan bombardimet e NATO-s. E bombardimet e NATO-s dhe kjo aleancë kosovare-perëndimore nuk është lidhur rastësisht, por pikërisht falë rezistencës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, rezistencës së çdo qytetari të Kosovës kudo që ka qenë në Kosovë e diasporë, që ndihmuan luftën për liri", ka theksuar presidenti Thaçi.

Duke vlerësuar rezistencën dhe heroizmin e dëshmorëve të lirisë, presidenti Thaçi i ka dekoruar me urdhrin "Hero i Kosovës" dëshmorët: Agim Ali Selmanaj, Arben Bajram Ahmetaj, Artan Ahmet Mehmetaj, Burim Sadik Mustafaj, Enver Hasan Halilaj, Fatmir Smajl Nimanaj, Hasim Misin Halilaj, Luan Gani Nimanaj, Naim Metë Nimanaj, Orhan Lan Halilaj, Sokol Muzli Sejfijaj, dhe Shpend Zeqë Malaj. Në kuadër të manifestimit qendror Epopeja e Dukagjinit liderët shtetërorë kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial "Dëshmorët e Kombit" në Gllogjan.





# Isak Shema, fitues i orës së madhe letrare 'Flakadani i Karadakut'

VITI, 24 MARS (ER) - Në kuadër të manifestimi tradicional mbarëkombëtar kulturor e sportiv "Flakadani i Karadakut 2019", në Viti është mbajtur ora e madhe letrare, në të cilën kanë marrë pjesë krijues, poetë dhe shkrimtarë nga hapësirat mbarëshqiptare. Në këtë aktivitet, që ka pasur karakter garues, vendin e parë e ka zënë prof. dr. Isak Shema me poezinë "Relikt", vendin e dytë e ka marrë Odise Plaku, kurse Vjollca Dibra është shpërblyer me vendin e tretë.
Në fillim të këtij aktiviteti, në emër të Komunës së Vitisë, një fjalë rasti e ka mbajtur zëvendëskryetari i kësaj komune, Hasan Aliu.
Gjatë këtij viti komisioni vlerësues për orën e madhe letrare ka qenë në këtë përbërje: prof. Agim Vinca, Zymrije Salihu dhe Ismajl Baftjari. Mirënjohjet për pjesëmarrësit dhe çmimet janë ndarë nga drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Milot Lala, Ramush Azemi, babai i dëshmorit Nijazi Azemi - komandant "Mjekra" si dhe Qahil Sinani nga Komuna e Vitisë.





# Përkujtohet 30-vjetori i demonstratës së grave në Ferizaj

Ferizaj, 24 mars (ER) - Tridhjetë vjet më parë, gratë dhe vajzat e Balajve, të cilave iu patën bashkuar edhe gratë e vajzat e Neredimes, Ferizajt e më gjerë, patën bërë aktin monumental të shembjes së heshtjes dhe durimit përballë represionit, shtypjes dhe robërisë jugosllave. Ato të bashkuara, shembull ndër të rrallë në botë, marshuan nga fshati Balaj drejt qendrës së qytetit të Ferizajt për ta kundërshtuar përpjekjen shtetërore të regjimit në minimin e substancës sonë kombëtare.
Me rastin e këtij përvjetori, kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, ka thënë se kjo ngjarje ka peshë të jashtëzakonshme historike. Po ashtu, me rastin e 30-vjetorit të nismës së kësaj demonstrate, qindra gra dhe vajza, banorë të fshatit Balaj, janë grumbulluar në oborrin e shkollës "Pavarësia" për ta zbuluar pllakën përkujtimore të titulluar "Guximi i gruas", e cila u kushtohet grave dhe vajzave të këtij fshati, Neredimes dhe Ferizajt, në shenjë mirënjohje dhe vlerësimi për punën e tyre.
Këtë pllakë bronzi të gravuar me shkronja të arta, ku janë skalitur fjalët më të merituara për këtë ngjarje, është zbuluar nga protagonistet e organizatoret e kësaj ngjarje: Sanie Aliu, Hatmane Sallauka, zonjat e fshatit Balaj Kefserja, Hanifja, Minirja, Safetja, Ibadetja, Ganimetja, Lulja, Mevlidja, të cilat, të bashkuara sikurse 30 vjet më parë, në demonstratën e 23 marsit 1989, shpalosën këtë pllakë përkujtimore.
Pjesë e kësaj ceremonie ishin edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës, Elmi Reçica, Mexhide Mjaku-Topalli, Bilall Sherifi, Labinot Tahiri, ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ish-kryetari i Ferizajt, Bajrush Xhemajli, zëvendësministra, drejtorë komunalë, kryesuesja e Kuvendit Komunal, familjarë të dëshmorëve, përfaqësues të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së dhe anëtarë të Kuvendit të Komunal të Ferizajt.
Pas zbulimit të kësaj pllake, në teatrin "Adriana" është mbajtur një akademi përkujtimore në të cilin ishte i pranishëm edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli.



# Digjet një shtëpi në Kërvasari të Malishevës

MALISHEVË, 24 MARS (ER) - Një shtëpi në fshatin Kërvasari të Komunës së Malishevës është djegur tërësisht dhe dhjetë anëtarë të kësaj familje kanë mbetur pa kulm mbi kokë. Këtë familje e ka vizituar kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, i cili ka thënë se kësaj familje do t'i bëhet një zgjidhje e shpejtë për strehim.
Gjatë vizitës në familjen e Lulzim Bytyçit, kryetari Begaj ka shprehur keqardhje për djegien e shtëpisë dhe, pas vizitës, ka deklaruar se do të shikohen të gjitha mundësitë për një zgjidhje të shpejtë për familjen Bytyçi, në mënyrë që t'i rregullohet shtëpia dhe të sigurohet banimi për të. Familja Bytyçi përkohësisht pritet të strehohet te të afërmit në Kërvasari.

# Komuna e Kaçanikut, e angazhuar për përkrahjen e bizneseve lokale

KAÇANIK, 24 MARS (ER) - Komuna e Kaçanikut, në bashkëpunim me organizatën "Help", ka filluar vizitat në terren, te bizneset ekzistuese dhe "start-up", të cilat kanë aplikuar për mbështetjen me grante në kuadër të projektit që financohet nga kjo komunë dhe organizatë.
Programi i vetëpunësimit ka për qëllim nxitjen e aftësive për punësim dhe ndërmarrësi dhe zgjerimin e mundësive për punë për të rinjtë nga Gjilani, Vitia, Kaçaniku dhe Hani i Elezit. Programi financohet nga USAID Empower Private Sector në partneritet me Sida-Styrelsen för Internationellt Utvecklingssamarbete.



# Që të ulet importi, kërkohet mbështetje e eksportuesve vendorë




Gjatë muajit shkurt të këtij viti Kosova ka eksportuar mallra në vlerë prej 24 milionë eurosh, ndërsa ka importuar 232.7 milionë euro. Për t'i bërë ballë këtij debalanci tregtar, kryetari i Shoqatës së Eksportuesve, Nexhat Hasani, dhe ai i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, kanë kërkuar nga Qeveria e Kosovës që ta ndjekin shembullin e vendeve të rajonit, duke subvencionuar eksportuesit në njësi të mallit

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 MARS - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka bërë me dije se të dhënat nga tregtia e jashtme në Kosovë për muajin shkurt të këtij viti tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 14.1 për qind në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2018, gjegjësisht në vlerë prej 208.6 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 182.8 milionë eurosh në vitin 2018. Sipas ASK-së, eksporti i mallrave në muajin shkurt 2019 kishte vlerën vetëm 24 milionë euro, ndërsa importi 232.7 milionë euro, ku vërehet rritje prej 7.4 përqindësh për eksport dhe 13.4 për qind për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018.

Lidhur me këtë çështje, kryetari i Shoqatës së Eksportuesve të Kosovës, Nexhat Hasani, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se debalanci kronik në Kosovë është si pasojë e mosmbështetjes së prodhuesve vendorë dhe eksportuesve. "Prej vitesh kemi debalancë të lartë dhe ende vazhdon që deficiti të jetë 12-14 për qind. Kjo është shqetësuese për ne si eksportues dhe për Qeverinë e Kosovës. Edhe përkundër që janë marrë disa masa nga Qeveria e Kosovës, masat nuk kanë qenë të duhura për ta stimuluar eksportin", ka thënë Hasani. Ai ka theksuar se Qeveria e Kosovës sikurse vendet e rajonit duhet ta subvencionojë në njësi eksportin, në mënyrë që disbalanci kronik të ndryshojë. "Kemi vendet e regjionit që subvencionojnë direkt eksportin. Turqia për çdo njësi të eksportit e subvencionon me 30 për qind, po ashtu Maqedonia dhe Serbia. Ne dhe Shqipëria jemi në një situatë të pafavorshme. Kështu që, aq sa interesohemi për eksport dhe aq sa japim mjete, e kemi edhe gjendjen reale", ka deklaruar Hasani.

Në këtë kontekst, ai ka thënë se sfidë për Kosovën mbetet mungesa e atasheve ekonomikë. "Atashetë nëpër ambasada nuk i kemi të caktuar, dhe ata që janë aktualisht nuk i njohin rrjedhat ekonomike të Kosovës. Ata janë familjarë të njerëzve të politikës dhe në një njëfarë forme s'i kontribuojnë prodhimit vendor, pasi nuk e zotërojnë punën që kanë marrë. Ne duhet të ulemi në një tryezë dhe të diskutojmë se për çfarë mase do të duhej që të subvencionohen prodhuesit vendorë. Produktet që tradicionalisht i kemi prodhuar duhet të subvencionohen për njësi në eksport", ka thënë Hasani.

Edhe kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se politikat në Kosovë shpesh kanë qenë në disfavor të bizneseve. Ai ka vlerësuar se është e nevojshme që të subvencionohen bizneset prodhuese. "Debalancin tregtar negativ Kosova e ka më të lartin në rajon si pasojë e krizave të njëpasnjëshme politike dhe ekonomike. Po ashtu, kemi edhe politika të pafavorshme karshi konkurrencës. Kosova mbetet një nga vendet më të mëdha sa iu përket importeve, ndërsa prodhon dhe eksporton më së paku", ka thënë Shahini.

Ai ka theksuar se trendi negativ që nga paslufta e këndej i shkëmbimeve tregtare do të vazhdojë derisa në Kosovë të kuptohet ekonomia, në mënyrë që sektori privat të jetë promotor i zhvillimit ekonomik. "Shpesh politikat në Kosovë kanë qenë pengesë për bizneset. Prodhuesit subvencionohen vetëm me një vlerë simbolike në fillim të biznesit si 'start-up'. Mos të harrojmë se në Serbi subvencionimi për bujqësi është 400 milionë euro, kurse tek ne rreth 50 milionë euro. Këto mjete nuk janë të mjaftueshme dhe kjo bën që ato vende të jenë më të fuqishme karshi konkurrencës. Kosova duhet t'i subvencionojë bizneset pasi në vazhdimësi mblidhen taksa dhe tatime nga bizneset. Kështu që, duhet t'u kthehen bizneseve në një formë që të gjenerohet rritja ekonomike", është shprehur Shahini.

## Kosova mund "të eksportojë" teknologji informative para resurseve natyrore

PRISHTINË, 24 MARS - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka thënë se rruga më e mirë që Kosova të pozicionohet në tregun ndërkombëtar është përmes ekonomisë digjitale dhe teknologjisë informative, më përpara se me resurse natyrore. Në një intervistë për "Ekonomia Online", Beqaj ka thënë se teknologjia informative (TI) në vitin 2018 ishte sektori i vetëm në Kosovë që kishte më shumë eksport sesa import.

Beqaj ka treguar se javën e kaluar ka prezantuar një projekt rajonal para komisionares për Ekonomi Digjitale të BE-së, Mariya Gabriel. "Projekti është për ekonomi digjitale dhe do ta trajtojë edhe çështjen e biznesit dhe të institucioneve. Do të flasë për 'Internet of things', ose 'Interneti i gjërave', që bën ndërlidhjen e të gjithë mekanizmave edhe për komunitetet 'smart'. Pra, ideja është të marrim modele të ndryshme të biznesit të cilat do të mundësojnë që teknologjia informative dhe në përgjithësi zhvillimi i ekonomisë digjitale të hyjë në funksion të rritjes së potencialit ekonomik", ka thënë ai.

Kur Qeveria Haradinaj kishte themeluar disa ministri, përfshirë Ministrinë e Inovacionit, kishte njerëz që kishin thënë se qëllimi është punësimi i militantëve partiakë. Por, Beqaj ka thënë se për një vit e gjysmë janë dëshmuar si shembull për krijimin e një institucioni që do të jetë një nga gjeneratorët e zhvillimit ekonomik të vendit dhe me njerëz të përgatitur. Beqaj ka theksuar se ministria që ai e drejton me buxhet e ka të lejuar të punësojë një staf prej 52 personave, por ky numër nuk është përmbushur ende.



# Ideja për ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë në vitin 1999 në dritën e burimeve arkivore amerikane



Prof. dr. Ibrahim GASHI

Dokumente arkivore të deklasifikuara në dy-tre vjetët e fundit, të cilat ndodhen në Arkivin Nacional të Shteteve të Bashkuara (National Archives and Records Administration - NARA) dhe në Bibliotekën e Presidentit Klinton (Clinton Presidential Library, Little Rock, Arkansas) hedhin dritë mbi politiken e Shtëpisë së Bardhë lidhur me zhvillimet në Kosovë gjatë gjysmës së dytë të vitit 1998 dhe idenë e ndërhyrjes ushtarake ndërkombëtare për ta parandaluar spastrimin etnik dhe gjenocidin që po kryente Millosheviqi në Kosovë.

Se ideja e ndërhyrjes ushtarake kundër forcave të Milloshevigit në Kosovë ishte e hershme dhe jo vetëm pas dështimit të bisedimeve në Rambuje flet një dokument i dalë nga zyra e presidentit Klinton. Fjala është për bisedën e regjistruar telefonike, të datës 6 gusht 1998, midis presidentit Klinton dhe kryeministrit britanik Tony Blair. Biseda u zhvillua nga zyra ovale në Shtëpinë e Bardhë dhe zgjati 20 minuta (4:46 p.m -5:06 p.m). Në fakt në këtë bisedë është deklasifikuar vetëm pjesa e bisedës së Presidentit Klinton por jo edhe përgjigjet e Kryeministrit Blair.

Sigurisht që nga konteksti i vazhdimit të bisedës se Presidentit Klinton në masë të caktuar mësojmë se edhe qëndrimi i Blairit ishte aprovues përgjithësisht.

Pjesa e madhe e kësaj bisede iu kushtua situatës në Kosovë. Pas fjalive përshëndetëse rutinore midis dy burrështetasve presidenti Clinton iu drejtua kryeministrit Blair. "Ju thirra që të bisedojmë për Kosovën. Atje po behët gjithnjë më keq. Kryetitujt flasin se Milloshevigi po preferon zgjidhjen ushtarake. Forcat ushtarake serbe nuk po luftojnë vetëm militantët e shqiptarë, por po angazhohen në një fushatë sistematike kundër popullsisë civile. Mendoj se ne jemi afër një katastrofe të madhe humanitare". Presidenti Klinton më tej vazhdon "Milloshevigi po e bënë këtë i pafrikësuar nga kërcënimi i intervenimit të NATO-s, i bindur se NATO mund të veproi vetëm më rezolutë të OKB-së, për të cilën është i bindur se do ta pengoi Rusia. Unë mendoj, që së paku ne duhet ta bëjmë atë të mendoi përsëri. Në duhet të vazhdojmë planin që kemi filluar, të identifikojmë forcat dhe të bëjmë një formë të ultimatumit më të cilin do ta detyronim atë ta ndërpriste fushatën e tij dhe të ripërtërinte autonominë e Kosovës".

Pjesa më e rëndësishme e kësaj telefonate është kur Presidenti Klinton i drejtohet bashkëbiseduesit "Ne duhet ta bëjmë të qartë, edhe pse duam ta marrim autorizimin nga OKB, ne mund ta bëjmë atë (ndërhyrjen) edhe pa të. E di që ju dalloni këtu por Albright ka folur më Cookin lidhur më pyetjen drejtuar KS të OKB-së sa është i domosdoshëm autoriteti i OKB-së". Vazhdimi i bisedës ka të bëjë më pozicionin që do të mbante Rusia. Klinton vazhdonte më tej. Jam në kontakt çdo ditë më Bob Rubin. Jam i shqetësuar për situatën ekonomike në Rusi dhe lidhur më stabilitetin e qeverisë së Yeltsinit. Shëndeti i tij është i renduar dhe çdo ditë ka zëra lidhur më mundësinë e tij për të ruajtur rendin".

"Ajo për të cilën jam i shqetësuar është se situate në Kosovë mund të përkeqësohet edhe më tej, shumë civil do të vdisnin dhe të tjerë do të ktheheshin në refugjatë. Nëse ne do ta fusnim Jelcinin në këtë marrëveshje, ai do të jetë i detyruar të abstenoj, sepse situate do të vështirësohej politikisht edhe më tepër për të në vendin e tij. Mbase ai mund të detyroj Primakovin të ushtronte vete duke e kthyer gjithë botën kundër tij, në kohën kur ai ka më së shumti nevojë për mbështetje nga komuniteti ndërkombëtar. Edhe pse do të ishte shumë më mirë ta kishim miratimin e OKB-së unë megjithatë jam shumë i shqetësuar nëse këtë çështje do ta sillnim për votim tani". "Milloshevigi mendon se i ka duart e lira", vazhdon Presidenti Klinton, "Unë bisedova më John Majer dhe ju keni sistem të ndryshëm lidhur më legalitetin atje. Një gjë që mendoj unë ne mund ta bëjmë, për të cilën mendoj se ka bazë: Atje kanë disa herë inkursione kufitare dhe kërcënime për vëzhguesit ndërkombëtar që mund t'i shtyj ata në vetë mbrojtje. Gjithashtu aty bëhet fjalë për kërcenim të Milloshevigit për paqen dhe sigurinë dhe pastaj edhe mizoritë dhe veprimet antihumanitare".

Pjesa e bisedës në vazhdim e konfirmon atë që të gjithë e kemi vërejtur, se iniciativa për sulme mbi forcat e Milloshevigit ka ardhur nga Presidenti Klinton. "Unë mendoj, shprehej Klinton, ne mundë të konstruktojmë një rast legal, por nëse unë nuk mund të ju bind juve për këtë, atëherë nuk kam asnjë shans me Chiracin dhe Kholin".

Siç e thamë më lartë, për arsye të konfidencialitetit, pjesa e përgjigjeve te Kryeministrit Blair nuk figurojnë në dokument. Në vazhdim të bisedës së tij Presidenti Klinton i drejtohet Blairit. "Të ju pyes a nuk do të provojmë të kemi Chiracin dhe Kohlin që ta nënshkruajnë një ultimatum të cilit do t'ia drejtojmë Milloshevigit. Fjala panifikim mund të ndihmonte. Ta bindim Chiracin dhe Kohlin se rezoluta e OKB-së nuk është legalishte domosdoshme".

Nga ky dokument mund të kuptojmë se ideja dhe iniciativa për sulme të NATO-s kundër caqeve serbe erdhi nga Presidenti Klinton dhe ShBA-ja, por u mbështet fuqishëm nga Britania e Madhe dhe pastaj edhe nga Franca dhe Gjermania. Federata Ruse atëbotë nuk ishte në pozicion që ta pengonte, prandaj dhe fillimisht nuk doli haptas kundër kësaj ideje.



## Bekim Azizi, zgjedhet kryetar i Degës së PDK-së në Viti

VITI, 24 MARS (ER) - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka përmbyllur zgjedhjet e brendshme në Degën e Vitisë, ku me shumicë të votave të delegatëve, kryetar i degës me vota të fshehta u zgjodh Bekim Azizi.

Kuvendi i Degës së PDK-së në Viti zgjodhi edhe Këshillin Drejtues me 57 anëtarë si dhe 12 delegatë për Kuvendin e Përgjithshëm.

Punimet e Kuvendit Zgjedhor të Degës, në emër të kryetarit Kadri Veseli, i ka përshëndetur nënkryetari i partisë, Hajredin Kuçi, njëherësh kryetar i Komisionit Qendror të PDK-së për Zgjedhje.

Në emër të Degës së PDK-së në Viti, delegatët i ka përshëndetur Skenderbe Hebibi, i cili përshkroi procesin zgjedhor, ku u mbajtën 31 kuvende nëndegësh me mbi 1 200 pjesëmarrës të cilët zgjodhën 137 përfaqësues në kuvend. Hebibi ka theksuar se po rikonfirmohet platforma Dekada e Re si vizion i së ardhmes të anëtarësisë së degës dhe qytetarëve të kësaj komune. Platforma e PDK-së, Dekada e Re dhe vizioni i liderit, Kadri Veseli, ka për qëllim zhvillimin e qëndrueshëm, ofrimin e hapësirës për kuadro të reja të cilat do të jenë në shërbim të ndërmarrësisë, ideve inovatore të qytetarëve brenda vlerave integruese, me besim dhe zhvillim.



# Lëvizjet nacionalçlirimtare dhe përdorimi i gabueshëm i fjalës 'ilegal' (2)

**Kush ishte ilegal në territoret shqiptare nën Jugosllavi? Grupet, organizatat dhe lëvizjet që angazhoheshin për çlirim kombëtar, apo ata që pushtuan territoret tona dhe që përpiqeshin t'i zbatonin ligjet e tyre në kundërshtim me vullnetin e popullit shqiptar?**



Bardhyl MAHMUTI

Në pjesën e parë të shkrimit theksova se çështja e legalitetit/ilegalitetit nuk ka për kriter vlerësimi formën e veprimtarisë, por ligjshmërinë e një veprimi. Gjithashtu përmenda se në raport me ligjshmërinë e veprimeve që shkëputën territoret shqiptare nga Shqipëria dhe ua ndanë si plaçkë shteteve fqinje, të gjithë veprimtarët për gjatë më shumë se një shekulli e kanë cilësuar si të paligjshme.

Në kohën kur u krijuan shtetet kombëtare në Ballkanin Perëndimor, Lidhja Shqiptare e Prizrenit hidhte poshtë si të paligjshëm çdo vendim që nuk përfillte vullnetin e popullit shqiptar të ndarë në katër njësi administrative (vilajete) të Perandorisë Osmane për të jetuar në një shtet të pavarur.

Me pushkë në dorë u kundërshtuan vendimet e Kongresit të Berlinit për ta ndarë Kosovën dhe pjesë të tjera të viseve shqiptare nga Shqipëria me qëllim që t'i kënaqnin aspiratat grabitqare të fqinjëve tanë.

Pa u zgjatur në detaje rreth atyre ngjarjeve po theksoj vetëm faktin se mijëra luftëtarë shqiptarë u vranë në periudhën 1878-1881, sepse kundërshtonin si të padrejtë dhe të paligjshëm copëtimin e territoreve tona.

Në përputhje të plotë me frymën e programit dhe qëndrimeve politike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të gjitha format e organizimeve të mëvonshme politike shqiptare e kanë konsideruar si të padrejtë dhe të paligjshëm copëtimin e territoreve shqiptare dhe okupimin e tyre nga shtetet fqinje të Shqipërisë.

Për periudhën që shkon prej kohës së okupimit të territoreve shqiptare nga Serbia e deri në Luftën e Dytë Botërore po citoj historianin britanik Noel Malcom. Në veprën e tij të titulluar "Kosova, një histori e shkurtër" ai thotë: "E vërteta - sa u përket fakteve legjitime- është ndryshe. Kosova ligjërisht kurrë s'ka qenë e bashkuar me shtetin serb" (Vepra e përmendur e Noel Malcomit, f. 275). Për këtë arsye, "nëse një shtet kishte okupuar ilegalisht ndonjë pjesë të një vendi tjetër kur i është bashkuar Lidhjes (së Kombeve), atëherë asnjë shtet tjetër nuk do të ishte i obliguar për ta mbrojtur atë okupim ilegjitim" (Vepra e përmendure Noel Malcomit, f. 276).

Kur kemi të bëjmë me ilegalitetin e aneksimit të territoreve shqiptare Jugosllavisë, vlen të theksohet se edhe vetë Partia Komuniste e Jugosllavisë në disa vendime të miratuara në kongreset e saja para Luftës së Dytë Botërore kishte ardhur te konkluzioni se shqiptarëve u ishte bërë padrejtësi e madhe. Po rikujtoj se në përputhje me qëndrimet e Partisë Komuniste të Jugosllavisë për respektimin e të drejtës së kombeve për vetëvendosje, Komiteti Krahinor i PKJ-së për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit mbajti Konferencën e saj në Bujan, në të cilën delegatët shqiptarë, serbë, malazezë dhe boshnjakë të Kosovës miratuan në mënyrë unanime rezolutën përmes të cilës përcaktohej qartë se pas përfundimit të luftës, Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit do të bashkoheshin me Shqipërinë, në përputhje me vullnetin politik të popullit të saj.

Miratimi i Rezolutës së Bujanit për bashkimin e Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit me Shqipërinë kishte edhe karakter ndërkombëtar, për faktin se në këtë mbledhje merrte pjesë Majori Baili, përfaqësues i Misionit Anglez që përfaqësonte Aleancën Antifashiste.

Dihet se në vend të respektimit të së drejtës së popullit të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit për vetëvendosje dhe bashkim me Shqipërinë, komunistët jugosllavë, në mënyrë të jashtëligjshme (ilegale), imponuan administrimin ushtarak në Kosovë dhe në Rrafsh të Dukagjinit.

Ky administrim vazhdoi deri në të ashtuquajturin "Kuvend i Prizrenit", ku 137 "delegatë" të emëruar nga Partia Komuniste e Jugosllavisë, prej të cilëve vetëm 32 persona ishin shqiptarë, vendosën që Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit t'i bashkëngjiten Serbisë.

Përmes kësaj mbledhjeje në "Kuvendin e Prizrenit", komunistët jugosllavë përpiqen të legjitimojnë ripushtimin e territoreve tona.

Nga cili do këndvështrim i të drejtës që të shihen vendimet e kësaj mbledhjeje del qartë se vendimet e saj ishin vendime ilegale, për arsye se ishin në kundërshtim të plotë me vullnetin e popullit të shprehur për bashkim me Shqipërinë.

Të gjitha grupet, organizatat dhe lëvizjet politike shqiptare në territoret që mbetën nën Jugosllavi,që u themeluan pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, kanë kundërshtuar në mënyrë kategorike pushtetin jugosllav dhe instalimin e këtij pushteti në territoret tona e kanë cilësuar si ripushtim. Pra nga këndvështrimi i së drejtës së kombeve për vetëvendosje, e drejtë që qëndron në themelet e të drejtës ndërkombëtare, pushteti jugosllav në territoret shqiptare ishte pushtet ilegal. dhe rrjedhimisht ligjet e këtij shteti kanë pasur karakter ilegal/të paligjshme.

Asnjë grup, asnjë organizatë dhe asnjë lëvizje asnjëherë nuk ka kërkuar leje nga pushteti jugosllav që të themeloheshin për realizimin e të drejtave tona kombëtare, por janë krijuar dhe kanë vepruar me qëllim të vetëm çlirimin e territoreve me shumicë shqiptare dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë.

Që nga korriku i vitit 1945, kur gjatë administrimit ushtarak të viseve shqiptare u mbajt i ashtuquajturi "Kuvend i Prizrenit", komunistët jugosllavë trumbetonin pandërprerë se gjoja "bashkimi me Serbinë ishte bërë me vullnetin e popullit shqiptar"! Kjo propagandë kishte vetëm një qëllim: t'i jepej legaliteti pushtetit ilegal që nuk respektoi vullnetin e shprehur në Konferencën e Bujanit.

Përveç individëve që ishin të integruar në strukturat e pushtetit të serbëve, të maqedonasve dhe të malazezëve dhe që trumbetonin se gjoja shqiptarët kishin vendosur të mos bashkoheshin me Shqipërinë, por të jetonin të copëtuar në mes tri republikave sllave, asnjë shqiptar nuk mund ta konsideronte të ligjshëm pushtetin e instaluar me dhunë nga komunistët jugosllavë. Përkundrazi, ky pushtet ishte pushtet ilegal në raport me vullnetin e popullit tonë, dhe vetëm si i tillë mund të cilësohej nga grupet, nga organizatat dhe nga lëvizjet politike shqiptare.

Disa reagime lidhur me shkrimin tim më imponojnë të ndalem në sqarimin edhe të termit "klandestin". Edhe pse kohët e fundit një numër gazetarësh përdorin këtë term për të emëruar emigrantët që hyjnë fshehurazi në një shtet të caktuar, kjo fjalë është me origjinë nga fjala latine "clandestinus" që do të thotë "i fshehtë" dhe që nuk ka asnjë lidhje as me çështjet e autoktonisë e as me ardhacakët në një vend të caktuar.

Kur bëhet fjalë për format e fshehta të veprimtarisë së grupeve, të organizatave dhe të lëvizjeve politike shqiptare në Jugosllavinë e dikurshme veçohen futja dhe shpërndarja e literaturës së ndaluar, shtypja dhe shpërndarja e gazetave të tyre, shtypja dhe shpërndarja e trakteve e komunikatave dhe aktivitete të kësaj natyre... Megjithatë nuk duhet të harrohet se krahas veprimtarisë së fshehtë të kontestimit të legalitetit të pushtetit jugosllav, grupet, organizatat dhe lëvizje politike shqiptare, në kontekste të caktuara historike, kanë zbatuar edhe forma të veprimtarisë së hapët të kontestimit të legalitetit të këtij pushteti. Si shembull do të përmend demonstratat e vitit 1968, ato të vitit1981 dhe protestave të viteve në vijim, demonstratat e vitit 1988, greva e përgjithshme e minatorëve të Trepçës dhe demonstratat e vitit 1989 kundër "Kushtetutës së Tankeve", demonstrata e 1 Tetorit 1997 etj. që janë vetëm disa shembuj të kontestimit në mënyrë të hapur të legalitetit të pushtetit jugosllav.

Qindra persona janë vrarë dhe mijëra të tjerë janë plagosur në demonstratat të cilat botërisht e bënë të njohur se për shqiptarët pushteti jugosllav është pushtet ilegal dhe se nuk gëzonte asnjë legjitimitet.

Dhe lufta kundër pushtetit ilegal jugosllav mbi trojet tona arriti kulmin e vet në luftën e armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjes dhe Bujanocit.

Edhe pse Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi na kanë konsideruar si "ilegal", ne kemi qenë legal (të ligjshëm) në përputhje me vullnetin e popullit tonë.

Serbia vazhdimisht i ka konsideruar si "ilegale" të gjitha format e organizimeve politike që kanë kontestuar legjitimitetin e saj në Kosovë. Edhe sot e kësaj dite ajo vazhdon të trajtojë vendimin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës nga Kuvendi i Kosovës si "vendim të njëanshëm dhe ilegal", edhe pse legalitetin e këtij vendimi e legjitimoi edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

Prandaj, nëse të kaluarën dikush ka përdorur gabimisht termin "ilegal" për grupet, për organizatat dhe për lëvizjet që kanë pasur për qëllim çlirimin e trojeve tona nga pushtuesit jugosllavë, tani është koha që të harmonizohet terminologjia dhe për këto struktura politike të përdoret mbiemri cilësor "çlirimtar", sepse është term më adekuat me qëllimet që kanë pasur grupet, organizatat dhe lëvizjet që nga ripushtimi i trojeve tona nga komunistët jugosllavë. Legaliteti i këtyre grupeve, organizatave dhe lëvizjeve buron nga e drejta e popullit shqiptar për vetëvendosje.

**(Fund)**

## May dhe mundësitë e një komploti kundër saj



**Londër, 24 mars** - Kryeministrja Theresa May mund të përballet me një komplot të ministrave me qëllimin për ta larguar atë dhe për pasojë kontrolli mbi procesin e daljes së Britanisë nga Bashkimi Evropian t'i kalojë parlamentit.
Në një nga momentet më të rëndësishme për vendin që nga Lufta e Dytë Botërore, politika britanike është përfshirë nga ethet. Rreth tre vjet që nga referendumi i vitit 2016 mbetet ende e paqartë se si dhe kur, apo nëse Brexit do të ndodhë ndonjëherë.
Ndërsa qindra-mija njerëz marshuan të shtunën në qendër të Londrës për të kërkuar një tjetër referendum për Brexit-in, May ishte temë e gazetës britanike "The Sunday Times" që shkruante se disa nga ministrat kryesorë po përgatisin një "komplot" më qëllimin për ta larguar atë.
Gazeta citonte 11 ministra të lartë të paidentifikuar dhe shkruante se ata kishin rënë dakord që kryeministrja duhej të largohej, duke pohuar se ajo ishte kthyer në një figurë helmuese dhe e paparashikueshme dhe se gjykimi i saj "nuk po funksiononte siç duhet".
I pyetur lidhur me komentet e gazetës "The Sunday Times" dhe gazetave të tjera rreth komplotit, ministri i Financave Philip Hammond tha se nuk mendonte se vendi gjendej përballë një situate të tillë.
"Ndryshimi i kryeministrit nuk do të na ndihmojë", tha Hammond, i cili shtoi se mënyra më e mirë për të bërë përpara do të ishte që parlamenti të miratonte marrëveshjen e May.

# Çfarë përmban raporti i prokurorit Mueller?

**Një nga pikat kryesore që Mueller, ish-drejtor i FBI-së, do të trajtonte, është nëse Trumpi apo ndihmësit e tij bashkëpunuan me rusët fshehurazi për ta dëmtuar fushatën e demokrates Hillary Clinton në vitin 2016 nëpërmjet emaileve të vjedhura nga Komiteti Kombëtar Demokrat dhe nga drejtuesi i fushatës elektorale Clinton?**



**Uashington, 24 mars** - Amerikanët janë në pritje të detajeve të hetimit të Prokurorit të Posaçëm Robert Mueller për ndërhyrjen në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016. Ai e dorëzoi raportin e vet konfidencial të premten te prokurori i përgjithshëm William Barr, i cili informoi në vazhdim udhëheqësit e Kongresit nëpërmjet një letre ku shprehet se "mund të kem mundësinë t'ju njoftoj për gjetjet kryesore të prokurorit të posaçëm, ndoshta që këtë fundjavë".
Por, ndërsa Barr po njihet me raportin, sipas zëdhënësit të Departamentit të Drejtësisë, përmbledhja që ai do t'i dërgojë Kongresit do të vonohet me të paktën edhe një ditë.
Zëdhënësi i Shtëpisë së Bardhë, Hogan Gidley, tha se Shtëpia e Bardhë nuk e ka marrë raportin dhe se as nuk është informuar rreth tij. Duke përsëritur qëndrimin e Sekretares së Shtypit të Shtëpisë së Bardhë, Sarah Sanders, të shprehur të shtunën, ai tha se hapat e mëtejshëm në këtë proces janë në dorën e Barrit.

### Pikëpyetjet kryesore

Disa nga pikat kryesore që Mueller, ish-drejtor i FBI-së, do të trajtonte janë:
A bashkëpunoi me rusët fshehurazi Donald Trump, apo ndihmësit e tij, për ta dëmtuar fushatën e demokrates Hillary Clinton në vitin 2016, nëpërmjet emaileve të vjedhura nga Komiteti Kombëtar Demokrat dhe nga drejtuesi i fushatës elektorale Clinton? Apo pati presidenti i ardhshëm thjesht fatin të përfitojë prej taktikave dashakeqe të Rusisë? A u mundua ai të sabotonte hetimin që pasoi, për të mbrojtur veten dhe këshilltarët e tij politikë dhe ndihmësit?
Hetimet kanë sjellë ngritje akuzash për 37 individë dhe entitete, shumica e tyre operativë rusë që nuk janë kapur. Shtatë persona, ndër ta pesë ish-bashkëpunëtorë të presidentit Trump, janë vetëdeklaruar fajtorë, si dhe pesë janë dënuar me burgim.
Ndër rastet e nivelit të lartë janë ish-këshilltari i sigurisë kombëtare Michael Flynn, që u vetëdeklarua fajtor për mashtrim të FBI-së rreth bisedave të tij me ambasadorin e Rusisë, si dhe Paul Manafort, ish-kreu i fushatës elektorale Trump, i cili u dënua rishtazi për një sërë veprash penale.
Pak përpara dorëzimit të raportit hetimor, pati spekulime të shumta se prokurori i posaçëm do të sugjeronte ngritje akuzash të mëtejshme, por nuk u ndërmorën hapa të tjera ligjore përpara dorëzimit të raportit te Departamenti i Drejtësisë.
Me dorëzimin e raportit, procesi hetimor i prokurorit Mueller është efektivisht i përmbyllur, por nuk u jep fund telasheve ligjore për presidentin. Gjatë muajve të fundit, prokurori Mueller ka deleguar pjesë të hetimit të tij te degët e prokurorëve të Shteteve të Bashkuara, ndër to edhe Distrikti Jugor i Nju Jorkut, ku prokurorët kanë filluar tashmë hetime të veçanta për Organizatën Trump dhe entitete të tjera të grupit Trump.

### Në çfarë stadi gjendet çështja?

Është ende e panjohur nëse raporti Mueller do të sjellë shpagimin për presidentin, apo ngritjen e akuzave për shkarkimin e tij nga Kongresi, apo ndonjë alternativë të rrëmujshme të ndërmjetme.
Në bazë të ligjit, është Prokurori i Përgjithshëm Barr që vendos nëse dokumenti do t'i bëhet i ditur Kongresit dhe publikut, dhe nëse po, cilat pjesë të tij.
Presidenti Trump e ka quajtur në mënyrë të përsëritur hetimin e prokurorit të posaçëm një "gjueti shtrigash" dhe ka këmbëngulur vazhdimisht se nuk ka prova të bashkëpunimit të tij me rusët. Ndërsa presidenti ka thënë se nuk e ka problem nëse raporti bëhet publik, ka gjasa të ketë shkëmbime të konsiderueshme ligjore mes Shtëpisë së Bardhë, Departamentit të Drejtësisë, avokatit personal të Trumpit, si dhe Kongresit, përpara se pjesë të raportit, apo i gjithi, të bëhen publike.
Rregullorja i kërkon prokurorit Mueller të paraqesë një "raport konfidencial" të gjetjeve të tij te Prokurori i Përgjithshëm, i cili duhet të njoftojë Kongresin për këtë zhvillim. Por, nuk ka asnjë parashikim ligjor që e detyron atë të informojë publikun.

## Zgjedhjet në Izrael, Netanyahu viziton Trumpin në Shtëpinë e Bardhë



**Tel-Aviv, 24 mars** - Vetëm dy javë para zgjedhjeve në Izrael, kryeministri Benjamin Netanyahu do të zhvillojë një vizitë në Shtëpinë e Bardhë sot (e hënë), disa ditë pasi presidenti Donald Trump deklaroi se është koha që ShBA-ja ta njohë sovranitetin e Izraelit në Rrafshnaltën e Golanit.
Para kthimit në Izrael të enjten, Netanyahu mund të pres një mirëseardhje të ngrohtë nga Trumpi, i cili po ashtu do të jetë nikoqir i një darke me të.
Ditë më parë, përmes një postimi në "Twitter", presidenti Trump deklaroi se Rrafshnalta e Golanit ka rëndësi strategjike dhe të sigurisë për Izraelin dhe rajonin. "Pas 52 vjetësh është koha që ShBA-ja të njohë plotësisht sovranitetin e Izraelit mbi Rrafshnaltën e Golanit, që është e një rëndësie strategjike dhe të sigurisë për Izraelin dhe stabilitetin rajonal", shkroi presidenti amerikan, Donald Trump.
Izraeli e mori nën kontroll këtë territor nga Siria pas luftës së vitit 1967. Siria vazhdimisht ka kërkuar të rikthejë sovranitetin mbi rajonin.
Kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, menjëherë reagoi duke falënderuar presidentin Donald Trump. "Në një kohë kur Irani kërkon të përdorë Sirinë si një platformë për të shkatërruar Izraelin, presidenti Trump pranon me guxim sovranitetin izraelit mbi Rrafshnaltën e Golanit", tha Netanyahu.







# BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.






E rrallë

## Bëhet zbulimi i madh i fosileve në Kinë



Shkencëtarët kanë bërë një zbulim 'mahnitës' të mijëra fosileve në një shtrat lumi në Kinë. Fosilet vlerësohen të jenë rreth 518 milionë vjeçare dhe janë veçanërisht të pazakonta sepse indet e trupit të shumë krijesave, duke përfshirë lëkurën, sytë dhe organet e brendshme, janë ruajtur në mënyrë të shkëlqyer. Paleontologët i kanë quajtur gjetjet 'një çmenduri', veçanërisht për shkak se më shumë se gjysma e fosileve janë specie të pazbuluara më parë.

FOTO E DITES



Një burrë në Meksikë qëndron pranë monumentit të një autobusi të shkollës në Uashington i prerë në gjysmë /Reuters/

E jashtëzakonshme

## Vdes, por kthehet në jetë pasi mjekët e çojnë në morg



Një postier vdiq për 21 minuta pas një ataku kardiak, por mrekullia ndodhi me të. Joao Araujo u kthye në jetë derisa mjekët po e çonin në morg. 48-vjeçari u përmbys në timonin e makinës kur po shkonte ta merrte gruan në punë. Pas gjashtë orësh përpjekje për ta shpëtuar, mjekët i thanë familjes së tij se Joao vdiq. Por, kur infermierët po e dërgonin në morg, vunë re se ai po lëvizte.

## BARSOLETA E DITËS



**Gardiani dhe shefi:**
**- Shefi: Kujdes shumë me këta të burgosurit, se janë tepër problematikë.**
**- Gardiani: Shef, sa të jem këtu s'do të ketë problematikë, se shkelma jashtë i qes.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Në ora 16:00

### "THE GRINCH" 3D,




I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney




Në ora 17:30

### "THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

### "MORTAL ENGINES" 3D,




Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers




Në ora 22:00

### "HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Propozimet tuaja do të ngjallin dyshime sot. Duhet të tregoheni me këmbëngulës për të arritur atë që doni.



**DEMI**
Edhe pse mund të keni zhgënjyer persona të caktuar sot, ajo që duhet të bënit është më e rëndësishme se gjithçka.



**BINJAKËT**
Edhe pse karriera ju shqetëson në këto momente, duhet të dini që nuk mund të zaptojë gjithë kohën tuaj.



**GAFORRJA**
Sot do të bashkëpunoni me persona të tjerë në realizimin e një projekti. Po eksperimentoni disa metoda që ju interesojnë.



**LUANI**
Keni lejuar disa persona që t'ju thonë se çfarë dhe si duhet ta bëni një gjë. Tani preferoni që t'i zgjidhni vetë problemet tuaja.



**VIRGJERESHA**
Po nervozoni personat pranë jush që do të preferonin të kaloni orë të këndshme në shoqërinë tuaj jo t'ju jepnin shpjegime të kota.



**PESHORJA**
Mbase po i kushtoni më shumë rëndësi seç duhet një situatë të caktuar. Në këtë ditë ju nevojitet të merrni vendime të prera.



**AKREPI**
Po lini pas vetes shumë çështje të pazgjidhura dhe shumë dyshime si në anën profesionale ashtu edhe në atë personale.



**SHIGJETARI**
Planet tuaja për ditën e sotme do të modifikohen nga personat që janë pranë jush. Kjo është një gjë mjaft e mirë sepse do të kënaqeni më shumë.



**BRICJAPI**
Duke ndenjur dhe duke u menduar pa fund mos kujtoni se do të zgjidhni problemet që ju shqetësojnë. Pak iniciativë për të lëvizur do t'ju bënte mirë.



**UJORI**
Dita e sotme do të shkojë shumë më keq seç e kishit menduar. Mjafton mos t'ju mposhtë pesimizmi.



**PESHQIT**
Nëse doni të vazhdoni të harxhoni kohë me gjëra të kota është në dorën tuaj. Bëni mirë t'i kushtoni më shumë kohë familjes tuaj.

# Kate Beckinsale largon të gjitha postimet nga "Instagram"-i




Kate Beckinsale ka hequr të gjitha postimet nga faqja e saj "Instagram". Aktorja 45-vjeçare, e cila momentalisht është në lidhje me Pete Davidson, e ka lënë të zbrazët profilin e saj, ndonëse llogaria e saj ende ekziston në rrjetet sociale.

# Rita Ora mban koncert në Dubai



Këngëtarja nga Prishtina, Rita Ora, mbrëmë ka mbajtur koncert në Dubai të Emirateve të Bashkuara Arabe. Rita ka thënë se është kënaqur shumë në koncert. "Dubai, ju e shkundët skenën. Unë jam kënaqur shumë. Deri herën tjetër. Ndalesa tjetër është në Nju Jork", ka shkruar Ria Ora në "Instagram".



# Jenniferi çdo ditë në palestër për rolin e ri të balerinës në film

Jennifer Lopezi është duke u formuar edhe më mirë për rolin e saj të ri të filmit ku do të aktrojë si një balerinë për kënaqësinë e shumë shikuesve në Manhatan. Jenniferi është parë duke ushtruar në një objekt në NYC. Mamaja e dy fëmijëve po përgatitet për filmin e ri "Hustlers", në të cilin luan edhe Cardi B.

# Naomi Campbell dhe Liam Payne më 22 maj bëjnë publike lidhjen e dashurisë





Supermodeluesja Naomi Campbell dhe këngëtari Liam Payne raportohet se janë në një lidhje dashurie. Një burim për "The Sun" ka thënë se në festën e ditëlindjes së Naomit, më 22 maj, do të bëhet publike lidhja e tyre e dashurisë. Ky burim më tej tha se ky është një hap i madh për ata pasi kalojnë nga shoqëria në dashuri.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | KOSOVA - BULLGARIA | 1 | MALI I ZI - ANGLIA | 2-2 | ANDORRA - SHQIPËRIA | 2 |
|---|---|---|---|---|---|---|

# Kosova me fitore synon t'i nisë kualifikimet për 'Euro 2020'

Kosova po synon t'i nisë me këmbë të mbarë kualifikueset për "Euro 2020". Trajneri Bernard Challandes ka thënë se, nëse "dardanët" luajnë mirë, mund ta mposhtin sonte Bullgarinë në "Fadil Vokrri". "Jam i kënaqur me paraqitjen kundër Danimarkës, por tani është më ndryshe. Ndaj Bullgarisë do të jetë ndeshje krejt tjetër. Bullgaria është ekip i fortë dhe ne duhet të luftojmë për çdo top. E dimë se Bullgaria ka përvojë më shumë se ne. Nëse luajmë mirë, kemi mundësi t'i marrim tri pikët. Ekipi është në një situatë të mirë, por mos të harrojmë se ata janë agresiv dhe do të na i vështirësojnë gjërat", ka thënë Challandesi

EPOKA E RE Veton ZYMBERI



**Prishtinë, 24 mars** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll sonte (e hënë) fillon ciklin kualifikues për Kampionatin Evropian "Euro 2020". "Dardanët" e drejtuar nga trajneri Bernard Challandes janë gati ta fitojnë ndeshjen e parë ndaj Bullgarisë, pasi motivi në përfaqësuese është i madh për faktin se në njëmbëdhjetë ndeshjet e fundit nuk kanë pësuar asnjë humbje.

Suksesi historik në Ligën e Kombeve dhe paraqitja e rezultatit në miqësore ndaj Danimarkës ditë më parë në stadiumin "Fadil Vokrri" është një tjetër motiv për Kosovën. Trajneri Bernard Challandes në konferencën e fundit para ndeshjes me Bullgarinë ka thënë se "Dardanët" mund të shënojnë fitore nëse luajnë mirë. Ai është ndalur edhe në analizën e kundërshtarit, duke thënë se bullgarët janë një ekip me përvojë të madhe. "Jam i kënaqur me paraqitjen kundër Danimarkës, por tani është më ndryshe. Ndaj Bullgarisë do të jetë ndeshje krejt tjetër. Bullgaria është ekip i fortë dhe ne duhet të luftojmë për çdo top. E dimë se Bullgaria ka përvojë më shumë se ne. Nëse luajmë mirë, kemi mundësi t'i marrim tri pikët. Ekipi është në një situatë të mirë, por mos të harrojmë se ata janë agresivë dhe do të na i vështirësojnë gjërat", ka thënë Challandesi.

Në konferencë për medie foli edhe mesfushori Hekuran Kryeziu, i cili mungoi në ndeshjen miqësore që u zhvillua më 21 mars ndaj Danimarkës. Anëtari i skuadrës së Zurichit ka thënë se me ndihmën e shikuesve Kosova mund të dalë fitimtare. "Kam stërvitur dhe besoj se do të jem gati për ndeshje. I kemi bërë disa analiza dhe jemi optimist pas lojës sonë kundër Danimarkës dhe me ndihmën e shikuesve mund t'ia dalim. Do të na presë një ndeshje më fizike pasi Bullgaria ka një ekip me lojtarë fizikë dhe do të na bëjnë ndeshjen e vështirë", ka thënë Kryeziu. Ndërsa anësori Arbër Zeneli në lidhje me përballjen ndaj Bullgarisë ka deklaruar: "Ndeshja me Bullgarinë është shumë e rëndësishme për ne dhe mendoj se miqësorja me Danimarkën na ka ndihmuar të hyjmë në ritmin tonë. Ai gol i pësuar në sekondat e fundit të ndeshjes me danezët na ka zhgënjyer paksa, por atmosfera është shumë e mirë dhe të gjithë jemi të përqendruar te dueli me bullgarët për ta dhënë 100 përqindëshin tonë. Në çdo lojë që hyjmë kemi respekt për kundërshtarin, por edhe ata tashmë kanë respekt të madh për ne, ngaqë e dinë se çfarë ekipi kemi. Realisht kemi sulmues shumë të mirë dhe jemi të bashkuar si ekip. Secili futbollist po e pret me padurim ndeshjen, sepse do të luajmë në fushën tonë para tifozëve tanë të zjarrtë, prandaj emocionet janë të mëdha".

Optimist për fitore është treguar edhe mbrojtësi i Bullgarisë, Petar Zanev. Ai ka thënë se bullgarët kanë marrë mësim pas barazimit 1-1 ndaj Malit të Zi dhe ndaj Kosovës duan tri pikë. "Jemi në gjendje të mirë, kemi marr mësim nga ndeshja me Malin e Zi dhe në ndeshjen ndaj Kosovës duhet të përqendrohemi. Kundërshtari ynë është një ekip nga ish-Jugosllavia dhe ka lojtarë të mirë, por ne do të fitojmë. Është gjithmonë mirë të luajmë në stadiume të mbushura, nuk mendoj se është një minus", ka thënë Zanev.

Ndeshja Kosovë - Bullgari zhvillohet sonte (e hënë) në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 20:45.

## Shqipëria kërkon fitore ndaj Andorrës

Kombëtarja e Shqipërisë në futboll sonte nga ora 20:45 luan si mysafire e Andorrës, në kuadër të Grupit H, për kualifikimet në Kampionatin Evropian. Kuqezinjtë synojnë fitore në këtë ndeshje, pasi në ndeshjen e parë pësuan humbje nga Turqia në Shkodër me rezultat 0-2. Pas humbjes është shkarkuar edhe trajneri Christian Panucci, kurse kombëtarja do të drejtohet nga ndihmësi i Panuccit, Edvin Bulku. Në kuadër të këtij grupi zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera: Moldavi-Turqi dhe Francë-Islandë.

## SHKURT

### Xhudo ia sjell tri medalje Kosovës nga Athina

Shpresa Olimpike 2018, xhudisti Shpat Zekaj (-100 kg), fitoi medaljen e bronztë në Kupën Evropiane për Juniorë që po mbahet në Athinë të Greqisë. Shpati shënoi tri fitore. Arbër Kullashi (-81 kg) fitoi katër luftëra dhe zuri vendin e shtatë. Ndërsa të shtunën Erza Muminoviq dhe Flaka Loxha i kanë siguruar dy medalje Kosovës. Erza fitoi të artën falë pesë fitoreve, katër me luftë, kategoria deri në 48 kilogramë. Medalistja e bronztë olimpike për të reja në finale mposhti austriaken Jaqueline Springer. Flaka, po ashtu, shënoi pesë fitore, katër me luftë. Në finale të kategorisë deri në 57 kilogramë ajo mundi austriaken Losa Grabner. Në kategorinë e njëjtë, Fationa Kasapi u eliminua në rrethin e parë. Laura Fazliu (-63 kg) humbi luftën për medaljen e bronztë, duke përfunduar e pesta.

### Tottenhami mendon për Strakoshën

Portieri Thomas Strakoshës nuk u grumbullua për ndeshjen që Shqipëria e zhvilloi ndaj Turqisë, por ai po shkëlqen me Lazion në sezonin aktual duke treguar vlerat e tij siç bëri edhe në derbin e fituar 3-0 ndaj Romës me disa pritje fenomenale. Mediet italiane raportojnë se për 24-vjeçarin shqiptar ka shfaqur interes gjiganti anglez Tottenham Hotspur. Drejtuesit e klubit londinez e shikojnë gardianin kuqezi si pasuesin ideal të kapitenit Hugo Lloris. Për kartonin e Strakoshës, Igli Tare kërkon minimalisht 40 milionë euro.

### Fitojnë Besa dhe Prishtina

Kampioni aktuale, Besa Famgas, ka fituar thellë ndaj Dritës në Gjilan. Ndeshja e javës së 23-të e Superligës A të Kosovës në hendboll (meshkujt) ka përfunduar me fitoren e Besës me rezultat 35:10. Pas pjesës së parë epërsia e ekipit pejan ishte 11 gola (17:6). Tetova shënoi më së shumti gola te Besa Famgas, gjithsej 8. Te Drita më efikasi ishte Misini me 5 gola. Besa Famgas është lidere me 42 pikë, ndërsa Drita e katërta me 20 pikë. Të shtunën u luajt ndeshja në mes të Prishtinës dhe Vushtrrisë. Fitore shënoi Prishtina me rezultat 32:26. Pas pjesës së parë Prishtina kishte vetëm një gol epërsi, 14:13. Te Prishtina më efikasi ishte Krasniqi me 7 gola. Tetë gola për vushtrriasit i shënoi Ademi. Prishtina është e treta me 34 pikë, ndërsa Vushtrria e gjashta me 18 pikë.

### Arsenali mbetet pa shqiptarë, pritet largimi i Mustafit dhe Xhakës

Granit Xhaka dhe Shkodran Mustafi po mbyllin sezonin e tyre të tretë tek Arsenali. Mustafi u transferua për 35 milionë nga skuadra e Valencias, ndërsa për të njëjtën shumë Xhaka u transferua nga skuadra e Borusia M'Gladbahut. Dyshja shqiptare kanë bërë mirë në aventurën e tyre londineze por, mesa duket, nuk do të qëndrojnë te "topçinjtë" në sezonin e ardhshëm. Mediet britanike bëjnë të sigurt faktin se Mustafi është nxjerrë në shitje nga trajneri Unai Emeri, i cili nuk është bindur nga paraqitjet e lojtarit me nënshtetësi gjermane. Për Mustafin ka interes të madh nga Seria A, ku ka luajtur më parë me Sampdorian, por dhe nga La Liga, ku flitet për një rikthim te Valencia. Ndërsa Xhaka është në planet e Unai Emerys, por mesfushori është shprehur për mediet zvicerane se është shumë ambicioz dhe Arsenali nuk është ndalesa e tij e fundit. Për 25-vjeçarin interesimi nuk mungon, por nuk ka ende një skuadër konkrete që është gati ta paguajë shumën që Arsenali synon, që është rreth 50 milionë euro.

## Kollari: Ndaj Ukrainës synojmë rezultat pozitiv

**Prishtinë, 24 mars** - Trajneri i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll U17, Besnik Kollari, ka thënë se djelmoshat e rinj të Kosovës janë gati për përballjen me Ukrainën. Sipas tij, në këtë ndeshje nuk synohet vetëm paraqitje e mirë, por edhe rezultat pozitiv. "Të gjitha ekipet me të cilat do të ballafaqohemi në këtë rreth janë jashtëzakonisht të forta dhe cilësore për faktin se janë kualifikuar për rrethin elitë. Mendoj se do të jenë ndeshje të forta e të vështira dhe kështu do të jetë edhe takimi me Ukrainën. Ne kemi punuar me përkushtim, në mënyrë që t'i kundërvihemi në mënyrën sa më të mirë dhe jo vetëm të kemi paraqitje të mirë, por edhe rezultat të mirë. Do ta bëjmë më të mirën e mundshme dhe mbetet të shihet se çka do të na sjellin këto ndeshje", ka thënë Kollari. Ndeshja në mes të Kosovës dhe Ukrainës është e vlefshme për rrethin elitë dhe zhvillohet sot (e hënë) nga ora 11:00.



# Shqipëria në kërkim të trajnerit, Hasi favorit



**Tiranë, 24 mars** - Pasi vendosi ta shkarkojë Christian Panuccin, presidenti i FShF-së, Armand Duka, së bashku me stafin e bashkëpunëtorëve, janë vënë në lëvizje për të gjetur një tjetër emër, që do të ulet në stolin e kuqezinjve. Sfida e sotme në Andorra i është besuar ndihmësit të Panuccit, Ervin Bulku, i cili do të asistohet edhe nga trajneri me përvojë, Sulejman Mema, ndërsa synimi është që Kombëtarja të ketë një trajner të ri në muajin qershor, për ndeshjet e radhës eliminatore. Edi Reja ishte emri i parë që u përfol se do ta marrë vendin e Panuccit, me teknikun 73-vjeçar që ishte edhe në tribunën e "Loro Boriçit", për të ndjekur nga afër sfidën përballë Turqisë. Presidenti i FShF-së nuk e mohoi Rejan si alternativë, ndonëse duket se nga takimi i parë mes palëve kanë mbetur shumë gjëra pezull. Ndërkohë, së fundi raportohet se është rikthyer fuqishëm një tjetër emër, ai i Luigi De Canios. Ish-trajneri i Udineses ishte një pretendent i fortë edhe për ta pasuar De Biasin, por atëherë garën e fitoi Panucci. Krahas italianëve, që duket se janë "të preferuarit" e FShF-së, për vetë faktin se vijnë nga një vend fqinj dhe e njohin mirë mentalitetin shqiptar, zgjidhja mund të vijë edhe me një ish të Kombëtares. Bëhet fjalë për ish-mesfushorin dhe kapitenin e kuqezinjve, Besnik Hasin, i cili aktualisht është i papunë dhe do ta mirëpriste një ftesë për t'i drejtuar kuqezinjtë. Gjakovari ka qenë një alternativë për ta drejtuar Shqipërinë edhe para se të ulej në stol De Biasi, por atëherë presidenti i Anderlechtit nuk e lejoi ta pranonte ofertën e Dukës. Vetë ky i fundit vlerëson kandidaturën e Hasit si njeri që njeh mirë ambientin dhe mentalitetin shqiptar, mund të ndihmojë në bashkimin e grupit dhe, mbi të gjitha, mund të sjellë ndonjë shqiptar të Kosovës më shumë në kombëtare. Megjithatë, "kastingu" sapo ka filluar dhe Duka me stafin e tij po kalojnë në "sitë" të gjithë alternativat e mundshme, për ta ofruar zgjidhjen më të mirë për stolin kuqezi.

### De Biasi: Dua të rikthehem

Ganni De Biasi, pas largimit nga Shqipëria, provoi një përvojë në Spanjë në krye të Alavesit. Që nga atëherë është folur shumë dhe ofertat nuk i kanë munguar italianit. Mezi pret të nisë të trajnojë dhe këtë e ka shprehur në një intervistë të dhënë për "Torinogranata.it". "Tani po bëj komentatorin në RAi për emisionin '90 minuti', por shpresoj të kthehem ta trajnoj në sezonin e ardhshëm", ka thënë De Biasi, i cili nuk mund të përjashtohet edhe si një opsion për ta zëvendësuar Christian Panuccin në kombëtaren shqiptare. "Kam refuzuar disa mundësi që më ofruan Frosinone dhe Venezia, por nëse arrin një propozim interesant për sezonin e ardhshëm, do të pranoj. Kam shumë dëshirë të kthehem të trajnoj dhe mendoj se i kam aftësitë për ta bërë diçka të tillë", përfundoi tekniku italian.

# Golden State turpërohet nga Dallasi, humbasin edhe Bostoni dhe Philadelphia

**Oakland, 24 mars** - Surpriza në takimet e luajtura në NBA. Kampionët e Golden States u mundën 126-91 nga Dallasi në fushën e vet, një nga ndeshjet më të dobëta këtë sezon të skuadrës së Warriorsit (mungoi Stephen Curry). Duranti realizoi 25 pikë, por që s'mjaftuan, ndërsa për ekipin teksan Donqiq realizoi një "triple double", me 23 pikë, 11 rebounde e 10 asistime (Nowitzki 21 pikë). Në sekondat e fundit fiton Atlanta, 129-127 ndaj Philadelphias, një ndeshje me rivalitet dhe emocione deri në fundin e saj. Ndeshje e mirë e Youngut, që realizoi 32 pikë e 11 asistime, mbështetur edhe nga Prince me 23 pikë, ndërsa për Philadelphian nuk mjaftuan 27 pikët e 12 reboundet e Embiid për ta evituar humbjen, raporton "Telesport". Humbet edhe Bostoni, që u ndal 124-117 nga Charlotte, takim i dominuar nga teksanët shumicën e kohës, por që gabuan në fund. Walkeri ishte shënuesi më i mirë, me 36 pikë e 11 rebounde, duke i bërë të pavlefshme 31 pikët e Irvingut për Celticsin. Utah Jazzi, falë 21 pikëve të Gobertit, mundi 114-83 Chicagon, ndërsa Portlandi mposhti 117-112 Detroitin falë 28 pikëve të Lillardit.



**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| CHARLOTTE - BOSTON | 124-117 |
| WASHINGTON - MIAMI | 108-113 |
| ATLANTA - PHILADELPHIA | 129-127 |
| CHICAGO - UTAH JAZZ | 83-114 |
| MEMPHIS - MINNESOTA | 99-112 |
| GOLDEN STATE - DALLAS | 91-126 |
| PORTLAND - DETROIT | 117-112 |
| SACRAMENTO - PHOENIX | 112-103 |

## SHKURT

### Istogu mposhti në derbi Prishtinën

Derbi i hendbollit në mes të Istogut dhe Prishtinës në konkurrencën e femrave është zhvilluar në Junik, ndërsa fitore ka shënuar Istogu me rezultat 31:25. Pjesa e parë përfundoi me rezultat 15:14 në të mirë të Istogut, e në fund Istogu doli fitues me rezultat 31:25. Pesë lojtare shënuan gola për Istogun. Rugova e Ujkiqi shënuan nga 7 gola, Ferataj e Muratoviqi nga 6, kurse Kameri realizoi 5 gola. Te Prishtina më efikasja ishte Stagova me 10 gola. Istogu është në vend të parë me 24 pikë, ndërsa Prishtina në vend të katërt me 18 pikë.

### Zidane: Dëshira ime ishte të luaja futboll, kisha vështirësi në shkollë

Zinedine Zidane arriti shumë si futbollist, por këtë e tregoi edhe si trajner. Në fare pak vite në krye të Realit ai fitoi gjithçka. Në një intervistë për "OTRO", francezi ka treguar peripecitë që ka kaluar për të qenë ky që është. "Dëshira ime e vetme ishte të luaja futboll dhe kisha vështirësi në shkollë. Prindërit nuk më penguan kurrë. Një ditë më thanë se duhet të bëja atë që dëshiroja. Sapo mora leje, dhashë gjithçka për të realizuar atë që dëshiroja. Që nga ai moment luftova për t'u bërë më i miri në botë. Pushoja dhe nuk bëja idiotin nëpër lokale, pija ujë dhe bëja stërvitje. Dhashë gjithçka që mundja për t'u kthyer në një lojtar të mirë. Vetëm kështu mund të lumturoja dhe bëja krenarë prindërit", ka thënë Zidane. "Ato kohë për të rënë në sy duhet të ishe i mirë, jo si tani. Duhet të tregoje se ishe ndryshe nga të tjerët, pasi kishte një numër të kufizuar të rinjsh në ekip. Sot çdo gjë ka ndryshuar dhe është më e shpejtë dhe lojtarët nuk kanë frikë të gabojnë", ka deklaruar Zidane.

### Bayerni dhe Liverpooli i shtohen garës për Chiesan

Interesimi i skuadrave për yllin e Fiorentinës, Federico Chiesa, po vazhdon të rritet vazhdimisht. Fillimisht Juventusi, Roma dhe Interi kanë shfaqur interesim për transferimin e Chiesas gjatë verës, kurse këtaj gare i janë shtuar edhe Bayern Muncheni dhe Liverpooli. Problemi i vetëm për momentin është çmimi i lartë i kartonit të tij në vlerë prej 100 milionë eurosh. Aktualisht futbollisti italian është ndër më të mirët në Serinë A.

### City, 100 milionë euro për Skriniarin

Skuadra e Manchester City duket se nuk do t'i ndalë shpenzimet as në afatin kalimtar të verës. Pep Guardiola është i vendosur ta përforcojë ende fazën defensive dhe tashmë duket se është mësuar emri i pëlqyer nga ai. Sipas raportimeve të 'Calciomercato', Manchester City po përgatit një ofertë 100 milionëshe për Milan Skriniar. Skriniar është kërkuar edhe nga rivalët lokalë të 'citizens', Manchester United, por oferta e tyre ishte refuzuar.

### Më 15 qershor përballen Fury - Schwarz

Ish-kampioni i botës në kategorinë e rëndë, britaniku Tyson Fury, do të përballet me boksierin gjerman Tom Schwarz në Las Vegas më 15 qershor. 29-vjeçari Fury do të boksojë për herë të parë që prej se e nënshkroi një marrëveshje fitimprurëse me transmetuesin amerikan ESPN në vlerë 80 milionë funte për pesë meçe boksi. Promotori i tij Frank Warren shpreson se Fury do të përballet përsëri me kampionin e WBC-së, Deontay Wilder, pas meçit të parë mes tyre që doli barazim. "Jam shumë mirë, shumë i gatshëm: mezi pres të luftoj. Schwarzi është i pamposhtur, i ri dhe ambicioz", ka thënë Fury. Schwarz është vetëm 24-vjeçar dhe renditet në vendin e dytë në botë në versionin WBO. Ai ka 24 fitore nga 24 meçe, 18 prej të cilave me nokaut.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*
*Ministria e Zhvillimit Ekonomik - Ministarstvo Ekonomskog Razvoja*
*Ministry of Economic Development*

